



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT  
DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

**RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PERFORMANCE**

*“Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike”*

**TIRANË 2025**

## P Ë R M B A J T J A

1. PËRMBLEDHJE.....	4
2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT .....	6
2.1 Konteksti i Problemit Social.....	6
2.2 Rëndësia e auditimit të performancës.....	7
3. SUBJEKTET NËN AUDITIM .....	7
3.1 Hyrje në subjektet nën auditim .....	7
3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim .....	12
3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit.....	13
3.4 Pesha në buxhet .....	13
3.5 Feedback-u i subjekteve në fazën studimore.....	14
4. DETAJET E AUDITIMIT .....	15
4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve .....	15
4.2 Objektivat e auditimit.....	16
4.3 Pyetjet e auditimit.....	16
4.4 Fushëveprimi i auditimit .....	17
5. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE .....	17
5.1 Si janë organizuar funksionet e inspektimit në vendin tonë? .....	17
5.2 A e ka përmbushur misionin e tij Inspektorati Qendror në përputhje me kuadrin ligjor? ...	25
5.3 A i kanë ushtruar kompetencat e tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore inspektoratet shtetërore dhe vendore? .....	31

## Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
BE	Bashkimi Evropian
3E	Ekonomiciteti, Eficienca, Efektiviteti
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
AN	Akt Normativ
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
IQ	Inspektorati Qendror
ISH	Inspektorate Shtetërore
IV	Inspektorate Vendore
NJVQV	Njësi e vetëqeverisjes vendore
SWOT	Pikat e forta, dobësitë, mundësitë dhe kërcënimet

.....

## 1. PËRMBLEDHJE

Inspektorati Qendror si institucion kryesor në fushën e inspektimit ka ushtruar veprimtarinë e tij në funksion të përmirësimit të efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë. Institucioni ka ushtruar kompetencat e veta për të bashkërenduar dhe mbështetur veprimtarinë e inspektorateve shtetërore. Ndër të tjera, ai ka dhënë mendime këshillimore për programet e inspektimit të inspektorateve shtetërore, si edhe ka miratuar kriteret arsimore për inspektorët etj. Ky institucion ka miratuar rregullat e përgjithshme të inspektimit për metodologjinë e vlerësimit të riskut, programimin e inspektimeve, dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve. Gjithashtu, ka miratuar edhe rregulla të përgjithshme për treguesit e përgjithshëm të efektivitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre.

Veprimtaria e Inspektoratit Qendror është zhvilluar sipas ligjit për inspektimin nr. 10433/2011, sikurse edhe inspektoratet shtetërore dhe vendore, së bashku me legjislacionet specifike për fusha të caktuara inspektimi. Ky ligj nuk ka qenë i përafuar me *acquis* e BE - së dhe deri në shtatorin e vitit 2024 nuk ka pësuar asnjë amendim. Zbatimi i këtij ligji është shoqëruar me problematika dhe mbivendosje kompetencash midis inspektorateve shtetërore duke u përkthyer në mbingarkesë për bizneset dhe menaxhim jo të përshtatshëm të funksioneve inspektuese.

Pikërisht për këtë arsye, në shtator të këtij viti u miratua ligji i ri nr. 99/2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”. Ky ligj ka për objekt përcaktimin e parimeve të përgjithshme të inspektimit, unifikimin e veprimtarisë së inspektimit, në nivel qendror dhe vendor, përcaktimin e funksioneve, rregullave dhe procedurave që zbatohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit, si dhe marrëdhënien e punësimit, rekrutimit, trajnimit dhe ecurisë në karrierë të inspektorëve, duke synuar një respektim më të mirë të lirisë së veprimtarisë ekonomike, pasi synon që të lehtësojë veprimtarinë e bizneseve, duke kontribuar kështu në një klimë më të favorshme për të ushtruar këtë liri.

Me hartimin e projektligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” është synuar përafrimi me “*best practices*” të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, ku fillimisht janë hulumtuar praktikatat e përdorura në vendet që kanë përvojë të suksesshme në inspektime. Ky ligj parashikohet të hyjë në fuqi brenda 6 mujorit të parë të vitit 2025.

Në periudhën tranzitore, ligji nr. 10433/2011 mbetet ende në fuqi. Në këtë drejtim, duhet theksuar se evidentimi i problematikave të tij, mund të orientojë vendimmarrjen e mëvonshme, në veçanti sa i takon miratimit të akteve nën ligjore në zbatim të ligjit nr. 99/2024.

Pavarësisht rolit udhëheqës dhe koordinues të ushtruar nga Inspektorati Qendror, funksionet inspektuese në nivel qendror dhe vendor në vendin tonë, nuk kanë arritur të zhvillojnë aktivitetin inspektues gjithmonë në mbrojtje të interesave të ligjshme të personave fizikë dhe juridikë. Arsye që kanë penguar koordinimin e duhur kanë të bëjnë me problematikatat e mbivendosjes së kompetencave inspektuese midis institucioneve duke krijuar barrë administrative për bizneset; por edhe mos - koordinim të vet institucioneve me funksione inspektuese, të cilat kanë dublikuar aktivitetin inspektues.

Çështje të tjera janë evidentuar nga IQ edhe sa i takon kryerjes së procesit inspektues. Më konkretisht, inspektoratet shtetërore nuk bashkëlidhin dokumentacion të plotë dhe të saktë për inspektimet, veçanërisht për njoftimet, kërkesat e shtyrjes dhe arsyet e realizimit të inspektimeve jashtë programit etj. Gjithashtu, ka mospërputhje të vazhdueshme mes datave të caktuara për inspektime, njoftime dhe vendime përfundimtare. Procedurat e inspektimit shpesh nuk janë në përputhje me legjislacionin, duke përfshirë mosrespektimin e afateve ligjore dhe klasifikimin e paqartë të kundërvajtjeve administrative. Në shumë raste, nuk respektohen afatet ligjore për paraqitjen e shpjegimeve nga subjektet ose për procedurat e ankimit.

Inspektoratet shtetërore jo gjithmonë i kanë respektuar kriteret e arsimit për pozicionet e punës “inspektor”. Gjithashtu, inspektoratet në nivel vendor ushtrojnë aktivitetin e inspektimit pa

mbikëqyrje nga Inspektorati Qendror. Për këto arsye është thelbësore që të sigurohet mbrojtja e interesave të ligjshme të qytetarëve dhe bizneseve, si një sfidë e së ardhmes për Inspektoratin Qendror në përmbushje të misionit tij. Inspektorati Qendror, si promotor në kuadër të ndryshimit të ligjit për inspektimin duhet t'i japë një impuls e kuptim të ri procesit inspektues si domosdoshmëri e rishikimit të problematikave dhe miratimit të rregullave të reja, duke synuar koordinimin dhe harmonizimin e tij në nivel qendror e vendor.

## 2. PROBLEMI SOCIAL DHE RËNDËSIA E AUDITIMIT

### 2.1 Konteksti i Problemit Social

Në vendin tonë roli kryesor i inspektimit është mbrojtja e interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë e juridik, duke ndihmuar bizneset në respektimin e kërkesave ligjore të parashikuara në legjislacionin përkatës. Ky funksion realizohet nëpërmjet këshillimit të subjektit të inspektuar për zbatimin sa më korrekt të ligjit, me qëllimin kryesor parandalimin e moszbatimit të ligjit dhe korigjimin e shkeljeve ligjore për eliminimin e pasojave që rrjedhin prej tyre, shmangien e rreziqeve që mund t'i shkaktohen interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave juridik dhe fizik.

Sipas një raporti të muajit maj 2023, në të cilin paraqitet situata e inspektorateve shtetërore në Shqipëri<sup>1</sup>, struktura e inspektimit ka ndryshuar për herë parë në vitin 2010. Sipas këtij raporti, qeveria shqiptare, në Samitin e Londrës për Ballkanin Perëndimor të korrikut 2018, u angazhua të reformojë përsëri fushën e inspektimeve duke zbatuar sistemin online, bazuar në metodologjinë e analizës dhe vlerësimit të riskut, me dokumente standarde nëpërmjet tabletave me sistemin e gjurmimit GPS, regjistrim me audio dhe video pranë biznesit dhe në prani të tij. Ky angazhim vinte dhe në përgjigje të raportit të BE-së për Shqipërinë të vitit 2018 ku theksohej se, pavarësisht progresit në reformën e inspektimeve dhe përmirësimin e kuadrit ligjor, ende ka nevojë për përmirësim të kuadrit ligjor, përafrim të legjislacionit sektorial me atë të BE-së, përmirësim të kapaciteteve institucionale, burimeve njerëzore, logjistikës dhe kapaciteteve laboratorike, si dhe domosdoshmëri për të forcuar funksionin e inspektimit dhe monitorimin e zbatueshmërisë së kuadrit rregullator nga bizneset.

Në raportet e progresit të BE-së në vijim<sup>2</sup>, kërkesat kanë qenë konkrete për inspektoratet sipas fushës së inspektimit dhe problematikave që shfaqnin. Referuar këtyre raporteve evidentohen problematika lidhur me inspektimet duke i konsideruar barrë e lartë administrative për sipërmarrjen. Ndër të tjera ato citojnë se zhvillohet një numër i lartë inspektimesh të cilat kalojnë dhe parashikimet ligjore për numrin total të ditëve për një biznes; ka mungesë transparence; kërkesa të paqarta lidhur me standardet ndaj të cilëve bizneset duhet të konformohen; numri i inspektimeve të paprogramuara zë një peshë të madhe përkundrejt totalit; sanksionet mbeten ende mjet kryesor për të siguruar zbatimin e ligjit; jo të gjitha inspektimet kryhen *online* apo janë të përfshira në sistemin *e-Inspektimi*; veprimtaria inspektuese në disa inspektorate vazhdon ende me kite portabël, jo me tableta.

Eksperiencat ndërkombëtare tregojnë që vendet e tjera ndeshen thuajse me të njëjtat problematika me ato që hasen edhe në Shqipëri dhe nuk janë të pakta reformat e ndërmarra për t'i adresuar ato.

Së fundmi, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar projektligjin për inspektimin, proces i cili ka nisur në tetor 2017 duke u finalizuar në shtator 2024 me miratimin e ligjit nr. 99/2024. Ndryshimet ligjore kanë ardhur si rezultat i problematikave të përmbledhura më sipër të cilat janë shprehur edhe nga media, bizneset dhe raportet e mbikëqyrjes së inspektimeve të kryera nga vetë Inspektorati Qendror. Me këto ndryshime ligjore pritet të ketë përmirësim të klimës së investimeve në Shqipëri, uljen e numrit të inspektimeve me qëllim zvogëlimin e barrës administrative për sipërmarrjen dhe krijimin e një klime të mirë për bizneset. Në këtë kuadër duhet theksuar se projektligji i sapo miratuar ende nuk ka hyrë në fuqi, e që ai të prodhojë impaktin e synuar duhet miratimi në kohë dhe me cilësinë e duhur i akteve nënligjore në zbatim të tij, sa i takon funksionimit dhe riorganizimit të fushave të ndryshme të inspektimit së bashku me institucioneve përkatëse.

Duke vlerësuar reformën dhe iniciativën e marrë nga institucionet për ndryshimin e statusit *quo* dhe përmirësimin të inspektimit, si shërbim në mbrojtje të interesave të qytetarëve,

<sup>1</sup> Raporti “Inspektoratet shtetërore në Shqipëri - Raport paraprak mbi situatën”, përgatitur në kuadër të projektit “Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri”.

<sup>2</sup> Progres raportet e BE – së 2019, 2020, 2021, 2022.

Kontrrolli i Lartë i Shtetit është orientuar drejt auditimit të kësaj tematike, me qëllim informimin e palëve të përfshira në këtë proces të problematikave të mëparshme, nxitjen e miratimit në kohë dhe me cilësinë e duhur të akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe për tu ardhur atyre në ndihmë drejt një vendimmarrjeje sa më të përshtatshme dhe me vlerë, në përfitim të qytetarëve.

## **2.2 Rëndësia e auditimit të performancës**

Auditimet e performancës vlerësojnë nëse synimet e politikave dhe skemat qeverisëse lidhen me problemet reale të shoqërisë dhe shqetësimet e palëve të interesit, duke dhënë një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjithë projekteve dhe programeve në entet publike të audituara. Këto auditime kryhen duke u bazuar tek Standardet Ndërkombëtare ISSAI dhe Udhëzuesi i Auditimit të Performancës (ISSAI 300, 3000, 3100, 3200, 5100 dhe 5200), Manuali i Auditimit të Performancës, Indikatorët e Performancës sipas praktikave më të mira audituese, të cilat shërbejnë si udhërrëfyes për konceptimin, planifikimin, kryerjen, konkludimin dhe ndjekjen e rekomandimeve të auditimit të performancës. Kontrrolli i Lartë i Shtetit, duke synuar realizimin e misionit të tij, si institucion që ofron një ekspertizë të pavarur në ndihmë të një menaxhimi sa më të përgjegjshëm në shërbim të qytetarëve, jep një informacion shumë më të gjerë mbi ecurinë e të gjitha projekteve dhe programeve të institucioneve dhe enteve publike të audituara. Nëpërmjet auditimit të performancës me temë *“Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike”* KLSH synon të paraqesë situatën aktuale të funksionit të inspektimit në vendin tonë në mbrojtje të interesave publike.

## **3. SUBJEKTET NËN AUDITIM**

### **3.1 Hyrje në subjektet nën auditim**


Subjekt i këtij auditimi ka qenë Inspektorati Qendror, i cili është institucion publik qendror, me seli në Tiranë, në varësi të Kryeministrit dhe që financohet nga Buxheti i Shtetit. Ai ka për mision përmirësimin e efektivitetit dhe përgjegjshmërisë së veprimtarive të inspektimit në Republikën e Shqipërisë.

Në ushtrimin e kompetencave të veta, Inspektorati Qendror ka për detyrë, ndër të tjera, të bashkërendojë dhe mbështesë veprimtarinë e inspektorateve shtetërore e të inspektorateve vendore, si dhe të jap mendim këshillimor për programet e inspektimit, të hartuara nga inspektoratet shtetërore etj. Ai miraton rregullat e përgjithshme bazë për metodologjinë e vlerësimit të riskut, programimin e inspektimeve, dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit, si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve. Gjithashtu, miraton edhe rregulla të përgjithshme për treguesit e përgjithshëm të efektivitetit dhe të cilësisë së veprimtarisë së inspektimit, si dhe kriteret e vlerësimit të tyre. Ka për detyrë të japë mendime për çdo nismë ligjore dhe nënligjore në fushën e inspektimit;

Inspektorati Qendror mbikëqyr zbatimin e ligjit për inspektimin dhe të çdo ligji të posaçëm nga inspektorët shtetërorë në lidhje me programimin, autorizimin dhe kryerjen e procedimit të inspektimit, si dhe ka të drejtë të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve dhe Kryeinspektorit Shtetëror, në rast të konstatimit të shkeljeve prej këtyre të fundit.

Funksionet e inspektimit në nivel qendror kryhen nga inspektoratet shtetërore, që janë institucione qendrore publike, në varësinë e një ministri përgjegjës. Si rregull, një inspektorat shtetëror është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën shtetërore të veprimtarisë së një ministrie. Përrjashtimisht, një inspektorat shtetëror mund të jetë pjesë përbërëse e një institucioni tjetër, në varësi të një ministrie, nëse parashikohet shprehimisht nga një ligj i posaçëm.

Skema 1. Inspektoratet Shtetërore dhe Inspektorati Qendror



Funksionet e inspektimit në nivel të qeverisjes qendrore në vendin tonë kryen nga 12 institucionet e mëposhtme:

- Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave (DPA) është organi më i lartë i rrjetit arkivor kombëtar. DPA është institucion qendror në varësi të Kryeministrit. Ky institucion kontrollon zbatimin e ligjit për arkivat si dhe të akteve nënligjore për punën me dokumentet në gjithë rrjetin arkivor të vendit, pavarësisht nga vartësia e tyre administrative. Ajo e ushtron këtë përgjegjësi edhe në arkivat e personave juridikë e fizikë privatë, që administrojnë dokumente me rëndësi historike kombëtare, si dhe vendos sanksione ligjore, bazuar në legjislacionin në fuqi. DPA është e organizuar në nivel qendror por burimet njerëzore i ka të shpërndara në 12 qarqet e RSH-së dhe ka gjithsej 19 inspektorë.

- Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar (AKAP) është institucion publik, në varësi të ministrit përgjegjës për arsimin, me seli në Tiranë. Kjo agjenci kryen veprimtarinë e saj sipas ligjit për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë dhe është struktura përgjegjëse për kontrollin e pajtueshmërinë së veprimtarisë së institucioneve arsimore publike dhe private për zbatimin e kërkesave ligjore e nënligjore në institucionet e arsimit parauniversitar, për të siguruar përmirësimin e cilësisë së shërbimit arsimor parauniversitar.

- Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet (ZMR) është autoriteti kompetent kombëtar në fushën e mbrojtjes nga rrezatimi, i cili ka dy nivele: Komisioni i Mbrojtjes nga Rrezatimet si organ vendimmarrës, i cili drejtohet nga Ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale; Zyra e Mbrojtjes nga Rrezatimet si organ ekzekutiv i saj që kryen inspektim konform detyrave, të përcaktuara në ligjet për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese dhe jo jonizuese. ZMR licencon veprimtaritë me burime të rrezatimit jonizues, veprimtaritë me burime të rrezatimit jojonizues; inspekton subjektet që kanë në përdorim burime të rrezatimit jonizues dhe sanksionet në rastin e shkeljeve të dispozitave ligjore.

- Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial (ISHTI) është institucioni qendror publik, buxhetor, në varësi të ministrisë përgjegjëse për energjinë dhe industrinë me kompetenca inspektimi. Ai ushtron funksionet e tij në zbatim të ligjit për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre, të ligjit për garantimin e sigurisë së punës së pajisjeve dhe instalimeve nën presion”, të ligjit për garantimin e sigurisë së punës të pajisjeve dhe të instalimeve elektrike”, ligjit për sektorin e gazit natyror”, etj. Ky institucion është organizuar



si drejtori e përgjithshme në nivel qendror, duke mbuluar gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. ISHTI, kryen inspektime në këto fushat inspektimi: inspektimi i gazit dhe i naftës; inspektimit i pajisjeve nën presion; inspektimi i pajisjeve dhe instalimeve elektrike; transmetim shpërndarje, tregtim, depozitim, ndërtim e operimin të infrastrukturës së gazit natyror.

- Autoriteti Kombëtar për Sigurinë dhe Emergjencat në Miniera (AKSEM) është person juridik publik, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për veprimtaritë minerare, me seli në Tiranë, që kryen inspektime në veprimtaritë minerare dhe ndërtimin e punimeve nëntokësore të veprave energjetike për verifikimin e zbatimit të kërkesave ligjore për sigurinë në punë e mbrojtjen e shëndetit të punonjësve gjatë veprimtarisë së tyre në. AKSEM, gjithashtu monitoron e mbikëqyr galeritë e minierave të mbyllura dhe jashtë përdorimi, gatishmërinë e plotë të personelit, pajisjeve dhe mjeteve për të ndërhyrë e përballuar situatën për shpëtimin e njerëzve, vlerëson, mbyll dhe monitoron grykat e punimeve minerare në minierat e braktisura, regjistron çdo subjekt që kryen veprimtari minerare dhe në punimet nëntokësore në veprat hidroenergjetike, vlerëson aftësitë teknike dhe profesionale të çdo personi fizik, që kërkon të përdorë e të kryejë punë me lëndë plasëse në subjekte apo të punojë si specialist për emergjencë dhe shpëtim, kryen vlerësimin e projekteve teknike, me qëllim pajisjen e subjekteve me autorizimin e përdorimit civil të lëndëve plasëse, analizon dhe regjistron rastet e emergjencave dhe të aksidenteve të rënda me rrezik apo humbje jete, etj.

- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor (ISHSH) institucion qendror, buxhetor, në varësi të ministrit përgjegjës për shëndetësinë. Ai është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, me përjashtim të inspektimit të veprimtarive në fushën farmaceutike. ISHSH, është i organizuar në dy nivele, qendror dhe rajonal, në 12-të qarqe të vendit. Në degët rajonale Tiranë funksionon njësi kufitare e inspektimit shëndetësor.

- Agjencia Kombëtare e Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore (AKBPM), është institucion në varësi të ministrisë përgjegjëse për shëndetësinë, specializuar për analizën dhe kontrollin e barnave, për dhënien e autorizimit për tregtim, për inspektimin e veprimtarive në fushën farmaceutike, për farmako – vigjilencën dhe për administrimin e standardeve të pajisjeve mjekësore. AKBPM, nëpërmjet laboratorit të kontrollit në QKKB, kryen analizat e barnave të të gjitha formave farmaceutike, siguron dhe përgjigjet për kontrollin cilësor të barnave brenda fushës së veprimtarisë së Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore, për të garantuar vendosjen në treg të barnave të sigurta, cilësore dhe efikase për popullatën. AKBPM -ja, në bashkëpunim me Laboratorin e Kontrollit Shtetëror Veterinar, kontrollon barnat që përdoren te kafshët, produktet e të cilave (mishi, qumështi, veza) përdoren si ushqim nga njerëzit.

- Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) ushtron veprimtarine e saj në zbatim të ligjit për mbrojtjen civile dhe ka mision kryesor krijimin e kushteve për një shoqëri të aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive, për të parandaluar, përgatitur, përballuar fatkeqësitë, si dhe për t'u rimëkëmbur nëpërmjet një sistemi efikas të saj. AKMC inspekton zbatimin e ligjit për mbrojtjen civile në institucionet dhe strukturat shtetërore dhe subjektet private.

- Agjencia Kombëtare e Bregdetit (AKB) është institucioni përgjegjës për inspektimin e kërkesave ligjore në fushën e turizmit për mbrojtjen dhe zhvillimin e një mjedisi të qëndrueshëm të zonës bregdetare, nëpërmjet monitorimit dhe kontrollit të të gjithë potencialit ekzistues të zonës bregdetare e detare dhe pasurive mjedisore që përfshihen brenda saj, si dhe kontrolli i veprimtarive turistike në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. AKB ushtron kontroll dhe inspekton në mjediset dhe në dokumentacionin e subjekteve që ushtrojnë veprimtari turistike; inspekton dhe monitoron rregulloren për disiplinimin e zhvillimit të veprimtarive turistike detare, që zhvillohen në zonën bregdetare dhe respektimin e rregullave për përdorimin e pasurisë së patjetërsueshme publike në zonën bregdetare.

AKB merr masa, vendos gjoba/masa administrative për shkeljet e konstatuara nga subjektet që ushtrojnë veprimtari turistike, në përputhje me dispozitat e ligjit; si dhe shqyrton ankesat për masat administrative dhe jobat e vendosura ndaj subjekteve.

- Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), është institucioni përgjegjës për inspektimin e kërkesave ligjore në fushën e mjedisit dhe ujërave. Drejtoria e Inspektim-Kontrollit (DIK), pranë AKM-së, është përgjegjëse për funksionin e inspektimit dhe kontrollit tematik për respektimin e kërkesave ligjore e të kushteve mjedisore, në zbatim të ligjeve për mbrojtjen e mjedisit, për mbrojtjen e ajrit nga ndotja, për menaxhimin e integruar të burimeve ujore dhe për menaxhimin e integruar të mbetjeve.

- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit (IKMT), është institucion buxhetor në varësinë e Ministrisë së Brendshme, përgjegjës për parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji (sipas VKM nr. 604 datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, i ndryshuar, i cili ka shfuqizuar VKM nr. 502, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme"). Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit është i strukturuar me drejtoritë përkatëse të tij në çdo qark të vendit dhe synon të shtrijë dhe të ketë një ndikim më të madh në territor me qëllim parandalimin dhe minimizimin e ndërtimeve pa leje në territor, parandalimin dhe kontrollin e mjedisit dhe pyjeve nga veprime të kundërligjshme dhe rritja e ndërgjegjësimit për një mjedis më të pastër në interes të gjithëve.

- Inspektorati Shtetëror i Mbikëqyrjes së Tregut (ISHMT) është përgjegjës për inspektimin në fushën e sigurisë së produkteve jo - ushqimore, për përdorim nga konsumatorët; pronësisë intelektuale, në fushën e metrologjisë, sipas legjislacionit për metrologjinë; instalimet teknologjike dhe industriale, për të siguruar mbrojtjen e konsumatorit, mbrojtjen e shëndetit publik, ruajtjen e një konkurrence të ndershme në treg dhe mbrojtjen e mbajtësve të së drejtës së autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me to.

- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) është institucioni përgjegjës për kontrollin e produkteve të ushqimit, produkteve ujore, produkteve me origjinë shtazore dhe jo shtazore, bimëve e produkteve bimore, input - eve bujqësore, si dhe për kontrollin e lëndëve të para të përdorura në industrinë e ushqimit e produktin përfundimtar, sipas parashikimeve në ligjin për ushqimin dhe ligjin për mbrojtjen e bimëve.

- Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH) kryen veprimtarinë e tij, përmes procesit të inspektimit, verifikimit të kërkesave ligjore për zbatimin e legjislacionit të punës dhe të shërbimeve shoqërore nga subjektet, në zbatim të ligjit nr. 9634 /2006 “Për inspektimin në punë” (i ndryshuar) si dhe Ligjit nr.121/2016 datë 24.11.2016 “Për “Shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, aktualisht është në varësi të Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. ISHPSHSH-ja siguron zbatimin e dispozitave ligjore për kushtet e punës dhe mbrojtjen e punëmarrësve në ushtrimin e profesionit të tyre, për kohëzgjatjen e punës, pagat, sigurimin, higjienën dhe mirëqenien, punësimin e fëmijëve, të të miturve dhe grave, si dhe për çështje të tjera, që lidhen ngushtë me to, në atë masë, që inspektorët e punës ngarkohen të sigurojnë zbatimin e këtyre dispozitave.

- Drejtoria e Shërbimeve të Peshkimit dhe Akuakulturës është një institucion qendror publik, në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me seli në Tiranë. Ky institucion ka për mision kontrollin në ujë apo në tokë, përfshirë portet, pikat e zbarkimit, mjetet e transportit, qendrat e grumbullimit të peshkut, merkatot, pikat e shitjes dhe restorantet, nëpërmjet aktiviteteve inspektuese sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Sektori i Inspektimit dhe Kontrollit të Peshkimit është gjithashtu, përgjegjëse për të monitoruar respektimin rregullsisë së zënieve që ndodhen në bordin e mjetit lundrues të peshkimit, të magazinuara, të transportuara, në përpunim apo të tregtuara, si dhe vërtetësinë dhe saktësinë e dokumenteve apo transmetimeve elektronike që lidhen me to.

- Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) ushtron funksion në zbatim të ligjit nr. 81/2017 “Për Zonat e Mbrojtura” dhe VKM nr. 102, datë 04.02.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura dhe të Administratave Rajonale të Zonave të Mbrojtura”. AKZM, ka si qëllim ruajtjen dhe kujdesin ndaj natyrës e biodiversitetit, habitateve dhe llojeve natyrore e gjysmë natyrore nëpërmjet:

- menaxhimit të rrjetit të zonave të mbrojtura me interes kombëtar e ndërkombëtar, sipas ligjeve kombëtare dhe konventave e marrëveshjeve ndërkombëtare;

- mbikëqyrjes së veprimtarive në zonat e mbrojtura dhe sigurimit të pajtueshmërisë së tyre në përputhje me kërkesat e këtij ligji dhe aktet të e tjera ligjore e nënligjore në fuqi;

- kontrollit për zbatimin e rregulloreve dhe kritereve për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore në zonat e mbrojtura e për kryerjen e veprimtarive ekonomike që zhvillohen brenda territorit të zonave të mbrojtura;

- monitorimit të zbatimit me përpikëri të instrumenteve të planifikimit e zhvillimit të territorit, të miratuara nga autoritetet qendrore dhe vendore në zonat e mbrojtura;

- kontrollit të aktiviteteve që përdorin burimet natyrore brenda rrjetit të zonave të mbrojtura.

- Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP) është krijuar dhe funksionon sipas ligjit nr. 57/2020 “Për pyjet” dhe VKM Nr. 570, datë 17.07.2019 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Pyjeve”, i ndryshuar, e garanton funksionalitetin e sistemit të kontrollit dhe të inspektimit të veprimtarive që zhvillohen në fondin pyjor kombëtar, duke ndërhyrë sipas përcaktimeve në këtë ligj”. Në këtë institucion funksionin kontrollues për pyjet, përmes procesit të inspektimit, e kanë strukturat:


- Struktura përgjegjëse në AKP (qendror dhe rajonal)

- Struktura përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki; - Struktura përgjegjëse në zonat e mbrojtura.

- Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve (AKVMB) është institucion në varësinë e MBZHR - së. Ky Autoritet funksionin në bazë të VKM nr. 683, datë 2.9.2020 “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve”. Misioni i AKVMB-së është të garantojë mbrojtjen e shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve, mbrojtjen e shëndetit publik në Republikën e Shqipërisë nga sëmundjet zoonotike të transmetueshme nga kafshët dhe mbrojtjen e bimëve, nëpërmjet drejtimit të veprimtarisë së kontrollit zyrtar dhe veprimtarive të tjera veterinare brenda fushës së përgjegjësisë, dhe ofrimit të shërbimit të mbrojtjes së bimëve nga dëmtuesit dhe sëmundjet.

Funksionet e inspektimit në nivel vendor krijohen apo përcaktohen me vendim të këshillit të njësisë vendore përkatëse, sipas legjislacionit për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore. Aktualisht në vendin tonë janë ngritur funksione inspektimi në 53 bashki si më poshtë:

Grafik 1 Fushat e Inspektimit dhe numër bashkish që kanë krijuar inspektorate ato fusha



Mbrojtja e territorit është fusha e inspektimit që mbulohet më tepër nga NJVQV – të, me 51 bashki që kanë krijuar strukturat përkatëse inspektuese për të mbuluar këtë fushë, ndërkohë që mbrojtja e konsumatorit është fusha e inspektimit më pak e mbuluar në rang vendi midis NJVQV – ve, me vetëm dy prej tyre që rezultojnë të kenë krijuar strukturat inspektuese për këtë qëllim.

### 3.2 Baza ligjore dhe kriteret e tjera që rregullojnë çështjen nën auditim

Baza ligjore mbi të cilën do të mbështetet ky auditim (pa përjashtuar këtu edhe akte të tjera ligjore/nënligjore apo praktika të mira që do të nevojiten për të kryer këtë auditim) është përmbledhur si më poshtë:

#### *Kritere teknike*

#### *Ligje, akte nënligjore dhe administrative:*

- ✓ Ligj nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;
- ✓ Ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”;
- ✓ VKM nr. 630 , datë 14.09.2011 “Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Qendror”;
- ✓ VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të inspektoratit qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e-Inspektimi”;
- ✓ Urdhër nr. 5, datë 19.02.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi programin e inspektimeve”;
- ✓ Urdhër nr. 6, datë 19.02.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë mbi metodologjinë e vlerësimit të riskut”;
- ✓ Urdhër nr. 7, datë 19.02.2015 “Për miratimin e rregullave të përgjithshme bazë për treguesit e efektivitetit dhe cilësisë së veprimtarisë së inspektimit dhe kriteret e vlerësimit e raportimit të tyre”;
- ✓ Urdhër nr. 13, datë 23.04.2015 “Për “miratimin e manualit të përgjithshëm të inspektimit në Republikën e Shqipërisë”.
- ✓ Rregullore për përcaktimin e procedurës së inspektimeve, si një proces i rregullt administrativ;

- ✓ Rregullore për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale gjatë procesit online të inspektimit;
- ✓ Rregullore e brendshme e Inspektoratit Qendror.

### 3.3 Rëndësia e produkteve të subjektit

Inspektorati Qendror në cilësinë e institucionit qendror buxhetor që mbikëqyr zbatimin e ligjit të inspektimit dhe ligjeve të tjera të posaçme në fushën e inspektimit gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij ka të drejtë të propozojë marrjen e masave disiplinore ndaj inspektorëve dhe Kryeinspektorit Shtetëror, në rast të konstatimit të shkeljeve prej këtyre të fundit. Në zbatim të këtij detyrimi, institucioni mbikëqyr veprimtarinë e inspektorateve shtetërore, si dhe harton e publikon raporte specifike për këtë qëllim. Nëpërmjet këtyre raporteve, Këshilli i Ministrave por edhe publiku dhe palët e tjera të interesit informohen mbi gjendjen, sfidat dhe problematikat e ndryshme që përballojnë inspektoratet specifike.

Ky institucion është thelbësor në mbarëvajtjen dhe funksionimin e duhur të fushave inspektuese të ndryshme në vendin tonë pasi nëpërmjet punës së tij, ai përgatit raportin vjetor të përgjithshëm të inspektimeve dhe e paraqet atë për njohje pranë Këshillit të Ministrave, duke informuar kështu në mënyrë objektive dhe të pavarur mbi arritjet dhe problematikat në fushën e inspektimit.

### 3.4 Pesha në buxhet

Buxheti i miratuar i Inspektoratit Qendror për periudhën 2021 – 2023 ka lëvizur midis 43,200,000 lekë të miratuar në vitin 2021, 40,437,500 në vitin 2022 dhe 43,941,000 në vitin 2023, me një reduktim me rreth 3,000,000 lekë në vitin 2022 e duke patur përsëri një rritje prej pothuajse 4,000,000 në vitin 2024. Inspektorati Qendror, pavarësisht se është një institucion shumë i rëndësishëm në drejtim të mbikëqyrjes që ushtron në tërësi për zbatimin e ligjit të inspektimit, uniformimit të metodologjisë etj., për shkak edhe të faktit se është një institucion relativisht i vogël<sup>3</sup>, në vite ka patur një buxhet të kufizuar.

Plani fillestar i buxhetit të institucionit sipas viteve paraqitet në tabelën e mëposhtme.

Tabela 1: Plan Buxheti fillestar i miratuar për vitet 2021, 2022, 2023.

Përshkrimi	2021	2022	2023
Paga	25,000,000	24,000,000	26,034,000
Sig.	4,100,000	4,100,000	4,307,000
Shp. Op.	11,000,000	10,800,000	10,500,000
NE	100,000	100,000	100,000
Shp. Kap.	3,000,000	3,000,000	3,000,000
<b>Total</b>	<b>43,200,000</b>	<b>42,000,000</b>	<b>43,941,000</b>

Plani i rishikuar, fakti dhe realizimi në % i buxhetit paraqiten në tabelën më poshtë.

Tabela 2 Plani i rishikuar, fakti, realizimi për vitet 2021, 2022 dhe 2023.

	2021			2022			2023		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Paga	25,000,000	20,646,421	82.59	23,400,000	22,053,259	94.24	26,034,000	25,566,996	98.21
Sig.	4,100,000	3,316,585	80.89	3,997,500	3,697,864	92.50	4,307,000	4,083,264	94.81
Shp. Op.	10,950,000	10,665,419	97.40	9,720,000	8,725,223	89.77	10,450,000	10,369,262	99.23
NE	150,000	150,000	100.00	320,000	310,817	97.13	150,000	122,509	81.67
Shp. Kap.	3,000,000	3,000,000	100.00	3,000,000	2,988,600	99.62	3,000,000	2,805,180	93.51
Total	43,200,000	37,778,425	87.45%	40,437,500	37,775,763	93.42%	43,941,000	42,947,211	97.74

<sup>3</sup>Për periudhën 2021 - 2023 Inspektorati Qendror ka funksionuar me 21 punonjës..

Sikurse mund të vërehet edhe nga tabela përmbledhëse më sipër, buxheti i këtij institucioni është alokuar kryesisht për të mbuluar shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, shpenzime të ndryshme operative, përfshirë këtu edhe një fond për transferta familjare dhe individë.

Tabela 3 Plani i rishikuar, fakti, realizimi shpenzime operative dhe kapitale për vitet 2021, 2022, 2023

Përshkrimi	2021			2022			2023		
	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%	Plan	Fakt	%
Sh. Korr.	40,200,000	34,778,425	86.51	37,437,500	34,787,163	92.92	40,941,000	40,142,031	98.05
Sh. Kap.	3,000,000	3,000,000	100	3,000,000	2,988,600	99.62	3,000,000	2,805,180	93.51
<b>Total</b>	<b>43,200,000</b>	<b>37,778,425</b>	<b>87.45</b>	<b>40,437,500</b>	<b>37,775,763</b>	<b>93.42</b>	<b>43,941,000</b>	<b>42,947,211</b>	<b>97.74</b>

Për vitin 2021, shpenzimet korente të institucioni janë realizuar në shumën 86.51%, për shkak të mos realizimit të plotë të zërave paga dhe sigurime shoqërore (respektivisht me 82.59% e 80.89%), kjo pasi për këtë vit struktura ka funksionuar me 20 punonjës e jo 21 sikurse është miratuar. Shpenzimet kapitale të planifikuara në vlerën 3,000,000 lekë janë realizuar në masën 100%. Sa i takon shpenzimeve kapitale duhet evidentuar se, vlera e akorduar ishte planifikuar për “Blerje tabletash dhe zhvillimi i tyre në sistem” si dhe për “Blerje kompjutera për zyrat e IQ – së dhe pajisje për mbrojtje serveri”, e do të prokurohej nga AKSHI. Për shkak se AKSHI nuk prokuroi në këtë drejtim, Inspektorati kërkoi rialokim fondi me qëllim likuidimin e detyrimeve të prapambetura sa i takon mirëmbajtjes së sistemit E – Inspektimi. Rialokimi i fondit u miratua nga MFE me shkresën nr. 17144/1, datë 22.10.2021.

Për vitin 2022, krahasuar me planin, buxheti i institucionit është pakësuar me aktin normativ nr. 3, datë 12.03.2022, e konkretisht: pakësohet llogaria paga (600) me 6,000,000 lekë, sigurime shoqërore (601) me 102,500 lekë, shpenzime operative (602) me 1,080,000 lekë. Me VKM nr. 898, datë 29.12.2022 është shtuar llogaria 606 me 220,000 lekë. Për këtë viti, institucion ka funksionuar me 18 punonjës, pra 3 më pak nga struktura e miratuar me urdhër të Kryeministrit. Sa i takon shpenzimeve kapitale, fondi prej 3,000,000 lekësh është realizuar në masën 99.62%. Ky fond ishte akorduar edhe këtë vit për “Blerje tabletash dhe zhvillimi i tyre në sistem”, që u prokuruan nga AKSHI.

Për vitin 2023, plani fillestar i miratuar i buxhetit të institucionit ka ndryshuar për shkak të pakësimit të llogarisë 602 me 50,000 lekë dhe shtimit të llogarisë 606 me po të njëjtën vlerë, miratuar me shkresën e MFE – së nr. 14815/1, datë 18.08.2023 lekë. Viti 2023 shënon edhe vitin me nivelin më të lartë të realizimit të buxhetit për institucionin me 97.74 %, rreth 10.29% më shumë se viti 2021 dhe 4.32% më shumë se viti 2022. Edhe në vitin 2023, institucioni ka funksionuar me organikë të reduktuar (18 punonjës e jo 21 sikurse është e miratuar). Sa i takon shpenzimeve kapitale, fondi prej 3,000,000 lekësh është realizuar në masën 93.51%. Ky fond ishte akorduar edhe këtë vit për “Blerje tabletash dhe zhvillimi i tyre në sistem”, që u prokuruan nga AKSHI (blerje pajisje hardware, 9 tableta për inspektime online për Inspektoratet Shtetërore).

### 3.5 Feedback-u i subjekteve në fazën studimore

Inspektorati Qendror gjatë fazës studimore të këtij auditimi është treguar i gatshëm dhe i hapur ndaj grupit të auditimit, duke vendosur në dispozicion dokumentet e kërkuara sipas afateve të përcaktuara nga grupi i auditimit. Informacioni i kërkuar është vënë në dispozicion i plotë në format elektronik dhe fizikisht sipas nevojës së grupit auditimit.

## 4. DETAJET E AUDITIMIT

### 4.1 Vlerësimi i risqeve të aktiviteteve të subjekteve

Nëpërmjet evidentimit të pikave të forta, pikave të dobëta, mundësive dhe kërcënimeve, grupi i auditimit ka bërë një ndarje dhe grupim të risqeve të veprimtarisë së institucioneve subjekt auditimi, për të adresuar dhe ndarë faktorët e riskut sipas përkatësisë së tyre, “brenda kontrollit menaxherial” dhe “jashtë kontrollit menaxherial”. Këto risqe janë analizuar, evidentuar dhe klasifikuar sipas analizës SWOT, në faktorë të brendshëm (pikat e forta dhe të dobëta) dhe faktorë të jashtëm (mundësitë dhe kërcënimet). Në vijim është bërë edhe kategorizimi i risqeve në strategjik, financiar, juridik dhe operacional, për të adresuar përgjegjësitë vendimmarrëse, të “input - it”, “procesit” apo “output - it”, etj.




Tabela 4 Kategorizimi i Riskut strategjik, financiar, juridik, operacional.

Nr.	Risku	Lloji i riskut	Niveli i riskut
1	Buxhete të pamjaftueshme për të përballuar procesin e riorganizimit	Risk financiar	I lartë
2	Kapacitete institucionale, infrastrukturore të pamjaftueshme në burime njerëzore, logjistikë dhe kapacitete laboratorike	Risk operacional	I lartë
3	Inspektime të dublikuara me kërkesa ligjore të njëjta nga inspektorate të ndryshme.	Risk operacional	I Lartë
4	Numër i lartë inspektoratesh për të koordinuar dhe mbikëqyrur.	Risk operacional	I Lartë
5	Trupa inspektuese me kualifikime të pa përshtatshme	Risk operacional	I Lartë

Përgatiti: Grupi i Auditimit

#### 4.2 Objektivat e auditimit


Auditimi me temë “*Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike*”, kishte si objektiv kryesor të sigurojë një vlerësim të paanshëm dhe objektiv nëse veprimtaria e përgjithshme e funksioneve të inspektimit në nivel qendror dhe vendor në vendin tonë është kryer sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara, me qëllim përmirësimin e klimës së biznesit në drejtim të uljes së barrës administrative për sipërmarrjen dhe mbrojtjen e interesave publike. Ky auditim u përqendrua në analizimin e situatës aktuale të mënyrës së funksionimit të deritanishëm të inspektimeve në nivel qendror dhe vendor, nëpërmjet rezultateve, mbikëqyrjes dhe të dhënave në dispozicion të Inspektoratit Qendror, në cilësinë e institucionin përgjegjës, ndër të tjera, edhe për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit për inspektimet dhe legjislacioneve të veçanta.

Më konkretisht, ky auditim u orientua kundrejt:

- mënyrës se si është organizuar dhe funksionon aktualisht inspektimi në vendin tonë dhe se si pritet që të funksionojë në vijim të miratimit të projektligjit të ri për inspektimin;
- trajtimit të veprimtarisë së Inspektoratit Qendror sa i takon përmbushjes së detyrimeve të tij ligjore në këtë fushë;
- evidentimit të marrëdhënieve të ndërsjellëta midis Inspektoratit Qendror, inspektorateve shtetërore dhe atyre vendore, duke synuar evidentimin e problematikave të ndodhura në këtë drejtim.

Një rëndësi të veçantë në këtë auditim ka pasur edhe trajtimi i mbivendosjes së kompetencave dhe dublikimet e mundshme të veprimtarisë së inspektorateve në nivel qendror apo vendor.

#### 4.3 Pyetjet e auditimit





#### 4.4 Fushëveprimi i auditimit

Auditimi i Performancës me temë “*Inspektoratet e vendit në mbrojtje të interesave publike*” ka në fokus analizimin e veprimtarisë inspektuese në vendin tonë duke përcaktuar nëse kjo ka siguruar mbrojtjen e interesave duke përmirësuar klimën e biznesit dhe sjellë përfitime për shoqërinë dhe qytetarët.

Në trajtimin e kësaj tematike, grupi i auditimit është fokusuar në mënyrë të veçantë në veprimtarinë e Inspektoratit Qendror, për arsye se ky është institucioni i cili deri më tani ka kryer funksione kyçe për të siguruar harmonizimin e funksioneve inspektuese në rang vendi nëpërmjet miratimit të metodologjive dhe formateve për inspektimin, trajnimin të inspektorëve dhe mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për inspektimet.

Perioda e auditimit, e përzgjedhur për trajtimin e kësaj teme, përfshin vitet 2021 – 2023, pa përjashtuar këtu edhe përfshirjen e periudhave kohore të mëparshme që mund të shpjegojnë çështje, fenomene dhe dukuri, të cilat reflektohen në situatën aktuale.

### 5. SHITJELLIMI I PYETJEVE AUDITUESE

Pyetja kryesore: **A ka garantuar legjislacioni në fuqi funksionimin e duhur të inspektimit, në mbrojtje të interesit publik dhe interesave të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë?**

#### MESAZHI I AUDITIMIT

Inspektorati Qendror, në cilësinë e institucionit përgjegjës për bashkërendimin e veprimtarisë inspektuese, ka ushtruar kompetencat e veta për të bashkërenduar inspektimet dhe mbikëqyrur ligjin e inspektimeve, si dhe ka miratuar kriteret për arsimimin e inspektorëve dhe rregulla e udhëzime të tjera metodologjike në këtë fushë.

Inspektoratet shtetërore nuk kanë siguruar përputhshmëri midis programeve mujore të inspektimit shkresor me atë elektronik; nuk janë respektuar kriteret e arsimimit të miratuara për punësimin e inspektorëve dhe janë kryer inspektime jashtë portalit “e – inspektimi”, etj. jo në përputhje me orientimet bashkërenduese e metodologjike të miratuara.

Për shkak të problematikave të bazës ligjore, ka pasur mbivendosje kompetencash e inspektimesh nga më shumë se një inspektorat, në veçanti në fushën e mjedisit midis AKM dhe IKMT – së.

Për të garantuar mbrojtje të interesit publik dhe interesave të tjerë të ligjshëm të personave fizikë dhe juridikë është miratuar ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” i cili synon të unifikojë dhe bashkërendojë veprimtarinë inspektuese në vendin tonë.

Inspektorati Qendror, si promotor në kuadër të ndryshimit të ligjit për inspektimin duhet t’i japë një impuls e kuptim të ri procesit inspektues si domosdoshmëri e rishikimit të problematikave dhe miratimit të rregullave të reja, duke synuar koordinimin dhe harmonizimin e tij në nivel qendror e vendor.

#### 5.1 Si janë organizuar funksionet e inspektimit në vendin tonë?

Funksionet e inspektimit në vendin tonë rregullohen me ligjin për inspektimin në Republikën e Shqipërisë<sup>4</sup>, i cili përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit, organizimin e institucioneve publike që kryejnë funksione inspektimi, statusin e inspektorëve, rregullat e procedimit administrativ të inspektimit dhe krijimin e funksionet e Inspektoratit Qendror.

Ligji për inspektimin përcakton funksionet dhe rregullat për ushtrimin e veprimtarisë së inspektimit në nivel qendror dhe vendor. Sipas këtij ligji nuk përfshihen në funksionet e inspektimit, inspektimi i brendshëm me karakter administrativ në sektorin publik, auditimi i brendshëm në sektorin publik e inspektimi financiar publik, kontrolli tatimor/doganor, si dhe

<sup>4</sup> Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”.

inspektimi i autoriteteve përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimi i terrorizmit; inspektimi i lojërave të fatit. Inspektorati Qendror është institucioni i cili udhëheq reformën e inspektimeve në vendin tonë dhe koordinon sistemin e inspektimeve brenda administratës publike në nivel qendror dhe vendor.

Funksionet e inspektimit në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore kryhen nga inspektoratet shtetërore, që janë institucione qendrore publike, në varësinë e një ministri përgjegjës, ku një inspektorat shtetëror është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën shtetërore të veprimtarisë së një ministrie. Inspektorati shtetëror kompetent për kryerjen e një funksioni inspektimi të parashikuar me ligj krijohet apo përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, i cili përcakton varësinë institucionale, rregullat e organizimit e të funksionimit të inspektoratit shtetëror, funksionet e inspektimit në kompetencë të tij, si dhe numrin dhe juridiksionin territorial të degëve të tij, nëse ka të tilla.

Organizimi i inspektorateve vendore bëhet sipas dispozitave të ligjit për vetëqeverisjen vendore<sup>5</sup>, ndërsa procedurat e inspektimit të inspektorateve vendore rregullohen sipas ligjit për inspektimin dhe metodologjitë e hartuara dhe miratuara nga Inspektorati qendror.

Njësitë Bashkiake në përgjithësi kanë këto fusha inspektimi: në mbrojtjen e territorit, mjedisit, pyjeve, në mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi, si dhe fushën e veterinarisë.

Sipas një raporti paraprak mbi situatën e Inspektorateve Shtetërore në Shqipëri të Majit 2023<sup>6</sup>, inspektimi në Republikën e Shqipërisë zhvillohet nën kompetencën e ministrive dhe inspektorateve në varësi si dhe pushtetit vendor. Roli i IQ-së, i krijuar në shtator 2011, është koordinues dhe rregullues, duke garantuar që veprimtaria inspektuese të jetë në frymën e ligjit dhe në koherencë të plotë me objektivat strategjike të tij, konkretisht duke siguruar:

- bashkërendim të inspektimeve;
- uljen e barrës administrative për bizneset;
- rritjen e efektivitetit të inspektimeve.

Në vendin tonë aktualisht janë 16 inspektorate shtetërore që mbikëqyren nga IQ, ndërkohë që numri total i inspektorateve/trupave inspektuese është 29 (përfshirë këtu degët rajonale të inspektorateve shtetërore). Në këto 16 inspektorate shtetërore që janë nën mbikëqyrjen e IQ, ka sektorë/degë të cilat janë jashtë mbikëqyrjes së tij, si për shembull në rastin e Pikave të Inspektimit Kufitar (PIK) të AKU - së, Mbrojtja e Bimëve tek AKVMB – ja apo fusha e ndërtimit në IKMT (të dhëna të IQ për vitin 2022).

Nga të dhënat e marra evidentohet se numri total i inspektorëve shtetërore është 2057 nga të cilët 689 në shërbim civil dhe 1368 me kod pune.<sup>7</sup>

Nga pikëpamja organizative ISH-të grupohen në këto kategori:

- Inspektorate në varësinë e një ministrie ose që janë pjesë përbërëse e një organi varësie, pranë një institucioni tjetër në varësi të një ministrie;
- Inspektorate që funksionojnë pa ose me degë territoriale.

### **Situata e kuadrit ligjor lidhur me inspektimin në vendin tonë**

Ligji për inspektimin në Republikën e Shqipërisë i vitit 2011, është ligji aktual në fuqi. Ky ligj nuk ka qenë i përafuar me acquis e BE - së dhe deri në shtatorin e vitit 2024 nuk ka pësuar asnjë amendim.

Pavarësisht faktit se ky ligj ka gjetur zbatim për një periudhë të gjatë kohore, duke konsoliduar funksionin e inspektimit në vendin tonë e duke justifikuar njëkohësisht nevojën për të në

<sup>5</sup> Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

<sup>6</sup> Raport i përgatitur në kuadër të projektit “Konsolidimi i shërbimeve publike me në qendër qytetarin në Shqipëri” (CSDA), i cili zbatohet nga qeveria shqiptare në partneritet me Programin e Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara (UNDP) dhe me bashkëpunimin Austriak për Zhvillim (ADC) si kontribuues kryesor, bashkë me UNDP-në.

<sup>7</sup> Të dhëna zyrtare të marra nga Regjistri Kombëtar i Inspektorëve, përditësuar më datë 11.07.2024.

kontekstin më të ngushtë të vendit tonë, implementimi i tij është shoqëruar me sfida të ndryshme. Në raportin paraprak mbi situatën e Inspektorateve Shtetërore në Shqipëri (Maj 2023), evidentohet pikërisht se kuadri ligjor dhe kapacitetet institucionale paraqet sfida e problematika të natyrave të ndryshme. Së pari, sipas këtij raporti, nga zbatimi i këtij ligji është evidentuar se kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, përfshirë dhe ai sektorial, lidhur me inspektimet nuk është “*business friendly*”, pra i kuptueshëm me lehtësi apo i thjeshtë në aplikim, duke u transformuar kështu në barrë administrative për bizneset.

Gjithashtu, në disa raste legjislacioni paraqet kundërshti dhe është i paqartë, duke lënë shumë herë vend për interpretime kontradiktore.

Po kështu, ka pasur edhe mbivendosje të kërkesave ligjore të inspektimit nga inspektorate me veprimtari inspektuese të fushave të ndryshme.

Inspektoratet kanë konflikte kompetencash mes gjithë niveleve: Qendror - Rajonal, Ministror-Inspektorat Qendror (IQ).

Përveç sa cituar më sipër, janë evidentuar edhe problematika të tjera si

- ✓ barriera të komunikimit ndërinstytucional;
- ✓ kapacitete institucionale e infrastrukture të pamjaftueshme, trupa inspektimi të pakualifikuara dhe me formim jo sipas kërkesave profesionale,
- ✓ marrëdhënie punësimi të pa unifikuara midis inspektorateve, si dhe mungesë të dhënash të rregullta, të standardizuara dhe të aksesueshme për veprimtarinë që kryhet.;
- ✓ performanca e ISH matet me tregues si numri i inspektimeve, shkeljeve ose gjobave.

Në analizë të situatës së inspektorateve në vendin tonë dhe ligjit aktual ka rezultuar se ligji për inspektimin në Republikën e Shqipërisë, në vetvete nuk i ka arritur pritshmëritë e kërkuara dhe gjatë implementimit është shoqëruar me problematika institucionale për shkak të vështirësisë në aplikimin e tij të lidhura me arsye strukturore, nuk ka mundur një dialog institucional të rregullt midis Inspektoratit Qendror dhe inspektorateve shtetërore e ministrive përkatëse, si dhe janë hasur mbivendosje të funksioneve midis inspektorateve, ku Inspektorati Qendror i cili kryen mbikëqyrjen e inspektimeve nuk ka arritur të zhvillojë autoritetin rregullator të nevojshëm.

Sa i takon marrëdhënies së Inspektoratit Qendror me inspektoratet vendore është evidentuar se ligji nr. 10433/2011 ngarkon Inspektoratin Qendror me detyrën për të siguruar bashkërendim midis nivelit qendror dhe vendor (neni 16, germa a, ligji nr. 10433/2011), por pa i siguruar mjetet për të kryer këtë proces. Sipas këtij ligji, IQ në drejtim të inspektorateve vendore ka vetëm këto kompetenca:

- miraton kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore; dhe mban listën e përditësuar të inspektorëve në detyrë për çdo inspektorat shtetëror dhe vendor dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit (neni 16, germa f dhe h, ligji nr. 10433/2011);

- Inspektorët shtetërorë dhe vendorë u nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm dhe testimit profesional fillestar përpara konfirmimit në përfundim të periudhës së provës dhe testimit periodik. Testimi profesional fillestar dhe ai periodik bëhen në bazë të një provimi që organizohet nga Inspektorati Qendror (neni 21, pika 1, ligji nr. 10433/2011).

Po kështu, edhe VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e - Inspektimi” nuk ka përfshirë inspektoratet vendore si përdorues të këtij sistemi duke u kufizuar vetëm tek inspektoratet shtetërore. Megjithatë, inspektorët vendorë janë trajnuar në kuadër të trajnimit të detyrueshëm edhe për përdorimin e sistemit. Kjo situatë, me miratimin e ligjit nr. 99/2024, ka ndryshuar duke i dhënë IQ – së kompetenca të plota.

## Risitë e ligjit nr. 99/2024

Ligji i ri për inspektimin<sup>8</sup> është një ligj që ka për objekt përcaktimin e parimeve të përgjithshme të inspektimit, unifikimin e veprimtarisë së inspektimit, në nivel qendror dhe vendor, përcaktimin e funksioneve, rregullave dhe procedurave që zbatohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit, si dhe marrëdhënien e punësimit, rekrutimit, trajnimit dhe ecurisë në karrierë të inspektorëve. Ky ligj ka si qëllim të sigurojë e të përcaktojë:

- parimet bazë të inspektimit, të mbrojtjes së interesit publik, transparencës dhe llogaridhënies në veprimtaritë e inspektimit;
- përmirësimin e vazhdueshëm të veprimtarisë inspektuese përmes këshillimit dhe informimit të subjekteve të inspektuara; rritjen efikasitetit të administratës publike, duke përfshirë teknologjinë në proceset e inspektimit;
- respektimin e të drejtave të subjekteve të inspektuara dhe mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit;
- organizimin, rregullimin dhe menaxhimin e veprimtarisë së inspektimit, në nivel qendror dhe vendor.<sup>9</sup>

Çdo fushë inspektimi e veçantë është e rregulluar me ligje sektoriale, pasi ligji për inspektimin nuk normon rregullime për fusha të caktuara/konkrete inspektimi, por synon unifikimin dhe konsolidimin e veprimtarisë dhe sistemit të inspektimeve<sup>10</sup>.

Një ndër objektivat parësore të ligjit të ri lidhet me përmirësimin e klimës së biznesit, krijimin e mundësive për një riorganizim të inspektorateve në bazë të fushave të lidhura me risqet e ngjashme, në bazë të metodologjisë së sugjeruar nga OECD. Përmirësimi i klimës së biznesit synohet të krijohet duke ndërtuar një kulture parandaluese, duke vendosur paralajmërimin si dënim administrativ kryesor në inspektimin e parë të trupës së inspektimit, si dhe këshillimin mbi synimin për ndëshkim.

Ligji i ri siguron një respektim më të mirë të lirisë së veprimtarisë ekonomike, pasi synon që të lehtësojë veprimtarinë e bizneseve, duke kontribuar kështu në një klimë më të favorshme për të ushtruar këtë liri. Për hartimin e projektligjit “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë” është synuar përafrimi me “*best practices*” të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian, ku fillimisht, që me nisjen e reformës në inspektime, janë hulumtuar praktikrat e përdorura në vendet që kanë përvojë të suksesshme në inspektime, si Franca, Britania e Madhe dhe pas analizimit dhe përshtatjes me kontekstin aktual, për të identifikuar mospërputhjet/boshllëqet, janë zhvilluar takime të shumta konsultative me ekspertë të fushës, vendas dhe ndërkombëtarë dhe grupet e interesit<sup>11</sup>.

Duke marrë në konsideratë relacionin për projektligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, pavarësisht qasjes institucionale për përafrimin e ligjit me “*best practices*” të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe risive që ai ka sjellë në funksion të përmirësimit të fushës së inspektimeve në vendin tonë, evidentohet fakti se në hartimin e tij nuk është synuar përafrimi me *acquis communautaire*<sup>12</sup>, e për rrjedhojë ky ligj nuk e respekton këtë kriter. Gjithashtu, ky ligj nuk është dërguar për komente pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sikurse parashikohet në Manualin për hartimin e ligjeve ku thuhet se projektligjet duhen dërguar edhe në Ministrinë e Integritetit, e cila ka detyrimin që të vlerësojë përputhshmërinë e tyre me *acquis*-në e BE-së.<sup>13</sup>

<sup>8</sup> Ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

<sup>9</sup> Neni 2, Ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>10</sup> Relacionin për projektligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

<sup>11</sup> Materiali për takimet konsultative të Inspektorit të Përgjithshëm;

<sup>12</sup> Relacion për projektligjin “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, paragrafi V: “Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin e Bashkimit Evropian (*acquis communautaire*).

<sup>13</sup> Manuali i hartimit të ligjeve, 2010.

Për sa më sipër, referuar manualit të hartimit të ligjeve, udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë<sup>14</sup> rregullores së Këshillit të Ministrave, hartuesit e ligjit duhet të sigurojnë që projektligjet dhe projektaktet nënligjore të respektojnë hierarkinë ligjore, si dhe duke marrë parasysh përafrimin me *acquis*-në e BE-së.<sup>15</sup>

Referuar ligjit të ri për inspektimet duhet evidentuar se në Kreun XIV “Ndryshime në ligjet e tjera që lidhen me dispozitat zbatuese të inspektimit”, janë përfshirë ndryshime në legjislacionet specifike të inspektimit sipas fushave: mbikëqyrja e arkivave; bujqësia; siguria dhe shëndeti në punë; shëndeti; arsimi parauniversitar; turizmi; mbikëqyrja e tregut; mbikëqyrja e trashëgimisë kulturore; mbikëqyrja e mjedisit dhe territorit. Në total në këtë ligj janë përfshirë ndryshime për 68 ligje të tjera specifike në të cilat parashikohen funksione inspektimi. Përfshirja e ndryshimeve në legjislacionet specifike sipas fushave të cituara më sipër në këtë ligj, është bërë me arsyetimin se ligji i ri për inspektimet është akt gjithëpërfshirës, sikurse parashikohet nga teknika legjislative<sup>16</sup>.

Ky ligj është kthyer nga Presidenti i Republikës për rishikim në Kuvend me dekretin nr. 357, datë 10.10.2024. Kuvendi pasi ka shqyrtuar rekomandimet e Presidentit ka vendosur mospranimin e tyre duke miratuar ligjin pa ndryshime. Ligji i miratuar nga Kuvendi do shpallet nga Presidenti brenda 20 ditësh dhe hyn në fuqi 6 muaj pas botimit në fletoren zyrtare. Po kështu, aktet nënligjore në zbatim të tij parashikohet të miratohen me hyrjen në fuqi të tij.

Megjithatë, duhet evidentuar se ky ligj do të sjellë ndryshime të rëndësishme në kuadër të përmirësimit të klimës së biznesit dhe efektivitetit të funksioneve inspektuese, duke garantuar bashkërendim të përgjithshëm, trupë inspektuese të specializuar, procese ankimimi transparente etj., nga të cilat mund të veçojmë sa më poshtë:

### **Bordi i inspektimeve**

Pranë Inspektoratit Qendror, i cili do të riemërtohet sipas ligjit të ri Inspektorat i Përgjithshëm, do të krijohet bordi i inspektimeve, si një organ bashkërendues dhe përcaktues i politikave dhe standardeve të përgjithshme të inspektimit, të cilat zbatohen gjatë veprimtarisë së inspektimit nga inspektoratet përgjegjëse. Kjo është një strukturë e re, e cila nuk ka qenë e parashikuar në ligjin e vitit 2011. Ky bord do të jetë një strukturë e përhershme, që ka për detyrë përcaktimin e standardeve dhe politikave të përgjithshme të inspektimit; përcaktimin dhe miratimin e treguesve të performancës në fushën e inspektimit; përcaktimin dhe miratimin e politikës së komunikimit në fushën e inspektimit; dhënien e mendimit në përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore në fushën e inspektimit. Përbërja dhe mënyra e funksionimit të tij do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.<sup>17</sup>

### **Marrëdhëniet e punësimit**

Rregullimi i marrëdhënieve të punësimit, ka ndryshuar krahasuar me ligjin e mëparshëm, pasi në të ardhmen këto do të rregullohen ekskluzivisht nëpërmjet kodit të punës, e jo si ka qenë me ligjin e vjetër, i cili parashikonte një regjim të dyfishtë<sup>18</sup>: sipas kodit të punës dhe ligjit për statusin e nëpunësit civil.

### **Komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë**

<sup>14</sup> Udhëzimi nr. 6 ,datë 29.04.2022, Neni 48 “ Tabela e Përputhshmërisë”

<sup>15</sup> VKM nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, kreu III, pika 2.5.

<sup>16</sup> Neni 42, Udhëzimi i Ministrisë së Drejtësisë nr. 6 ,datë 29.04.2022 “Për përcaktimin e metodologjisë së unifikuar për hartimin e akteve normative”.

<sup>17</sup> Neni 14, Ligji nr. 99, date 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>18</sup> Neni 17, Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

Pranë Inspektoratit të Përgjithshëm do të ngrihet komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë, i cili do të përbëhet nga 3 anëtarë: 2 anëtar përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm; 1 anëtar, përfaqësues nga inspektorati qendror, i cili ka shpallur vendin vakant. Kompetencat e komisionit të rekrutimit dhe ecurisë në karrierë kanë të bëjnë me: organizimin e procedurave të rekrutimit dhe ecurisë në karrierë, të përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave; vlerësimin e inspektorëve në procedurat e rekrutimit dhe ngritjes në detyrë; vlerësimin fillestar të inspektorëve në fund të kohës së provës, si dhe vlerësimin periodik; paraqitjen e kandidatëve fitues në përfundim të procedurave të ministrit përgjegjës në rastin e kryeinspektorit qendror dhe të kryeinspektorit qendror për pozicionet e tjera. Rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit të rekrutimit dhe ecurisë në karrierë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Me ligjin e viti 2011 procesi i rekrutimit kryhet në mënyrë të decentralizuar sipas inspektorateve.

### **Komisioni disiplinor**

Pranë Inspektoratit të Përgjithshëm do të ngrihet, rast pas rasti, komisioni disiplinor, i përbërë nga 2 anëtarë, përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm dhe 1 anëtar, përfaqësues nga inspektorati qendror, ku inspektori ka emërimin. Komisioni disiplinor për procedimin disiplinor të kryeinspektorit qendror ka në përbërje 2 përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm, 1 anëtar përfaqësues i ministrit përgjegjës të inspektoratit qendror, ku kryeinspektori ka emërimin. Komisioni disiplinor është kompetent për procedimin disiplinor dhe marrjen e masave përkatëse ndaj inspektorëve të inspektorateve qendrore, për veprime ose mosveprime, në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit disiplinor do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave<sup>19</sup>.

### **Komisionet e shqyrtimit të ankimit pranë Inspektoratit të Përgjithshëm dhe NJVQV - ve**

Pranë Inspektoratit të Përgjithshëm do të ngrihet komisioni i shqyrtimit të ankimit, si një organ kolegjal për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të ankimit sa herë që është nevojshme. Ankimi administrativ i paraqitur nga subjekti i inspektimit kundër vendimit përfundimtar në fushën e inspektimit të inspektorateve qendrore dorëzohet dhe shqyrtohet pranë komisionit të shqyrtimit të ankimit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Me ligjin e vitit 2011, komisionet e shqyrtimit të ankimit, të dënimeve dhe masave administrative ishin të ngritura pranë inspektorateve përkatëse (struktura të brendshme), ku një pjesë e vendimeve përfundimtar të inspektimit i nënshtroheshin ankimit administrativ nga subjektet. Me ligjin e ri, komisioni i shqyrtimit të ankimit do të përbëhet nga dy përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm; një përfaqësues nga ministria përgjegjëse e inspektoratit qendror, ndaj të cilit është drejtuar ankimi; një përfaqësues nga inspektorati qendror, ndaj të cilit është drejtuar ankimi; një përfaqësues nga organizata joqeveritare me aktivitete në fushën e biznesit apo nga organet e përfaqësimit të biznesit. Edhe në këtë rast rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave<sup>20</sup>. Po kështu, pranë NJVQV – se, do të ngrihet komisioni i shqyrtimit të ankimit si organ kolegjal për të zhvilluar procedurën e shqyrtimit të ankimeve sa herë që është e nevojshme, në rastet e vendimeve të marra nga organet e vetëqeverisjes vendore. Çdo ankim administrativ i paraqitur nga subjektet e inspektuara kundër vendimeve përfundimtare në fushën e inspektimit të organeve të vetëqeverisjes vendore dorëzohet dhe shqyrtohet pranë komisionit të shqyrtimit të ankimit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative. Përbërja dhe numri i anëtarëve të komisionit të shqyrtimit të ankimit

<sup>19</sup> Neni 22, Ligji nr. 99, date 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

<sup>20</sup> Neni 55, Ligji nr. 99, date 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

përcaktohen nga organi kompetent i njësisë së vetëqeverisjes vendore, në përputhje me ligjin për vetëqeverisjen vendore dhe me këtë ligj. Megjithatë, ligji i ri vendos një kriter sa i takon përbërjes së këtij komisioni, pasi parashikon se në përbërje të tij duhet të jetë një përfaqësues nga organet e përfaqësimit të biznesit, si dhe mund të ketë një përfaqësues nga Inspektorati i Përgjithshëm. Për sa më sipër, ligji përcakton se, rregullat e hollësishme për funksionimin e komisionit të shqyrtimit të ankimit pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në vijim të miratimit të ligjit nr. 99/2024 parashikohet që të miratohen rreth 15 akte nën ligjore.

**1. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi, funksionet e inspektimit në vendin tonë janë rregulluar me ligjin nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, i cili përcakton parimet e përgjithshme të inspektimit, organizimin e institucioneve publike që kryejnë funksione inspektimi, statusin e inspektorëve, rregullat e procedimit administrativ të inspektimit dhe krijimin e funksionet e Inspektoratit Qendror. Ky ligj, i cili nuk ka qenë i përafuar me *acquis* të BE – së, përcakton gjithashtu edhe funksionet e inspektimit në juridiksionin e pushtetit ekzekutiv të qeverisjes qendrore. Këto funksione kryhen nga inspektoratet shtetërore, që janë institucione qendrore publike, në varësinë e një ministri përgjegjës, ku një inspektorat shtetëror është përgjegjës për të gjitha funksionet e inspektimit në fushën shtetërore të veprimtarisë së një ministrie. Organizimi i inspektorateve vendore bëhet sipas dispozitave të ligjit për vetëqeverisjen vendore<sup>21</sup>, ndërsa procedurat e inspektimit të inspektorateve vendore rregullohen sipas ligjit për inspektimin dhe metodologjitë e hartuara dhe miratuara nga Inspektorati qendror. Me hyrjen në fuqi, në maj të vitit 2025, funksionet e inspektimit do të rregullohen sipas ligjit nr. 99/2024 “Për Inspektimin e Republikën e Shqipërisë”.

**2. Gjetje nga auditimi:** Ligji nr. 10433/2011, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, ngarkon Inspektoratin Qendror me detyrën e bashkërendimit të veprimtarisë inspektuese midis nivelit qendror dhe atij vendor (neni 16, germa a, ligji nr. 10433/2011), por pa i siguruar mjetet për të kryer këtë proces. Sipas këtij ligji, IQ në drejtim të inspektorateve vendore ka vetëm këto kompetenca: miraton kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve në inspektoratet shtetërore dhe vendore; dhe mban listën e përditësuar të inspektorëve në detyrë për çdo inspektorat shtetëror dhe vendor dhe e publikon atë në faqen zyrtare të internetit (neni 16, germa f dhe h, ligji nr. 10433/2011); inspektorët shtetërorë dhe vendorë u nënshtrohen trajnimit të detyrueshëm dhe testimit profesional fillestar përpara konfirmimit në përfundim të periudhës së provës dhe testimit periodik. Testimi profesional fillestar dhe ai periodik bëhen në bazë të një provimi që organizohet nga Inspektorati Qendror (neni 21, pika 1, ligji nr. 10433/2011). Po kështu, VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e - Inspektimi” nuk ka përfshirë inspektoratet vendore si përdorues të këtij sistemi duke u kufizuar vetëm tek inspektoratet shtetërore. Megjithatë, inspektorët vendorë janë trajnuar në kuadër të trajnimit të detyrueshëm edhe për përdorimin e sistemit. Kjo situatë, me miratimin e ligjit nr. 99/2024, ka ndryshuar duke i dhënë IQ – së kompetenca të plota.

**3. Gjetje nga auditimi:** Ligji nr. 10433/2011, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH” ka gjetur zbatim për një periudhë të gjatë kohore, duke konsoliduar funksionin e inspektimit në vendin tonë e duke justifikuar njëkohësisht nevojën inspektive, megjithatë implementimi i tij është shoqëruar me sfida të ndryshme. Në raportin paraprak mbi situatën e Inspektorateve

---

<sup>21</sup> Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

Shtetërore në Shqipëri (Maj 2023), evidentohet pikërisht se kuadri ligjor dhe kapacitetet institucionale paraqesin sfida e problematika të natyrave të ndryshme. Sipas këtij raporti, kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, përfshirë dhe ai sektorial, lidhur me inspektimet nuk është “*business friendly*”, pra i kuptueshëm me lehtësi apo i thjeshtë në aplikim, duke u transformuar kështu në barrë administrative për bizneset. Në disa raste legjislacioni paraqet kundërshti dhe është i paqartë, duke lënë shumë herë vend për interpretime kontradiktore. Gjithashtu, ka pasur edhe mbivendosje të kërkesave ligjore të inspektimit nga inspektorate me veprimtari inspektuese të fushave të ndryshme e konflikte kompetencash mes gjithë niveleve inspektuese. Për këto arsye, në shtatorin e vitit 2024 është miratuar ligji i ri për inspektimet nr. 99/2024 “Për Inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i cili hyn në fuqi në maj të vitit 2025.

**4. Gjetje nga auditimi:** Ligji i ri për inspektimin<sup>22</sup> është një ligj që ka për objekt përcaktimin e parimeve të përgjithshme të inspektimit, unifikimin e veprimtarisë së inspektimit, në nivel qendror dhe vendor, përcaktimin e funksioneve, rregullave dhe procedurave që zbatohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë së inspektimit, si dhe marrëdhënien e punësimit, rekrutimit, trajnimit dhe ecurisë në karrierë të inspektorëve. Njëpërmjet miratimit të këtij ligji kanë ndryshuar disa aspekte thelbësore të funksioneve inspektuese në vendin tonë. Këto ndryshime kanë të bëjnë me: krijimin e Bordit të inspektimeve; uniformimin e marrëdhënieve të punësimit; krijimin e Komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë; përbërjen dhe funksionimin e komisioneve disiplinore; si dhe përbërjen dhe funksionimin e Komisioneve të shqyrtimit të ankimit pranë Inspektoratit të Përgjithshëm dhe NJVQV – ve. Pavarësisht këtyre risive, në vijim të këtij ligji parashikohet që të hartohen dhe miratohen rreth 15 akte nën ligjore të tjerë.

**5. Gjetje nga auditimi:** Ligji i ri për inspektimet nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, sa i përket vlerësimit të shkallës së përafrimit me legjislacionin e BE – së, sikurse edhe ligji nr. nr. 10433/2011, është hartuar pa konsideruar përafrimin e tij me *acquis communautaire*. Gjithashtu, ai nuk është dërguar për komente pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sikurse parashikohet në Manualin për hartimin e ligjeve ku thuhet se projektligjet duhen dërguar edhe në Ministrinë e Integritetit, e cila ka detyrimin që të vlerësojë përputhshmërinë e tyre me *acquis-në* e BE-së. Po kështu, referuar manualit të hartimit të ligjeve, Udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë dhe Rregullores së Këshillit të Ministrave, hartuesit e ligjit nuk kanë siguruar respektimin e hierarkisë ligjore, si dhe nuk kanë marrë parasysh përafrimin me *acquis-në* e BE-së.<sup>23</sup> Në kushtet kur, në vijim të hyrjes së këtij akti në fuqi, parashikohen që të miratohen akte të tjerë nën ligjore për të plotësuar kuadrin e përgjithshëm, është thelbësor vlerësimi rast pas rasti i shkallës së përafrimit me legjislacionin e BE – së.

**Konkluzion 1:** Problematikat e evidentuara gjatë zbatimit të ligjit nr. 10433/2011, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në RSH”, kanë sjellë si pasojë ndërhyrjen për ndryshimin e tij, për ti adresuar ato në një mënyrë të re.

**Konkluzion 1:** Fakti që nuk është bërë një vlerësim paraprak mbi përafrimin me legjislacionin e BE – së, mund të çënojë procesin e reformimit në fushën e inspektimeve, në veçanti sa i takon hartimit të akteve nënligjore në zbatim të tij në përputhje me kërkesat specifike të *acquis* të BE - së.

**5.1 Rekomandim:** Inspektorati Qendror, i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm me ndryshimet ligjore, në procesin e dhënies së mendimeve për aktet nën ligjore që do të hartohen

<sup>22</sup> Ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”

<sup>23</sup> VKM nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, kreu III, pika 2.5.



dhe miratohen për të vënë në zbatim ligjin nr. 99/2024 në kontekstin e riorganizimit të funksioneve inspektuese në rang vendi, të monitorojë dhe raportojë në vijimësi shkallën e përfrimit me legjislacionin e BE – së për këto akte.

*Në vijimësi*

## **5.2 A e ka përmbushur misionin e tij Inspektorati Qendror në përputhje me kuadrin ligjor?**

Programi i inspektimit vjetor dhe mujor është instrumenti kryesor që përdorin ISH - të për planifikimin e akteve të inspektimit në subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari lidhur me verifikimin e kërkesave ligjore, për secilën fushë inspektimi. Ky program hartohet mbi bazë kriteresh objektive, tematike, vlerësim rrisht dhe ka si qëllim planifikimin sasior të inspektimit dhe përcaktimin e tematikave përgjatë vitit.

Sistemi “e - Inspektimi”, është ndërtuar mbi metodologjitë e miratuara nga IQ, ku ISH - të janë të detyruar të zbatojnë standardet e inspektimit në përputhje me këto metodologji dhe mos respektimi i tyre bën të pa mundur funksionimin e sistemit, planifikimin mujor, pra mos kryerjen online të procesit inspektues.

Të gjitha ISH - të përdorues të sistemit "e - Inspektimi", kanë dërguar të gjitha programet vjetore të inspektimit për dhënie mendimi pranë IQ – së si dhe kanë gjeneruar planet vjetore të inspektimit për vitin 2021, 2022, 2023, pas dhënies së mendimit përfundimtar këshillimor nga IQ.

IQ, ka bashkërenduar veprimtarinë e inspektorateve shtetërore për ISHPSHSH, ISHSH dhe AKU duke analizuar programet mujore të inspektimit dhe për subjekte të përbashkëta inspektimi, është dërguar email dhe shkresë zyrtare për koordinimin e inspektimeve duke caktuar subjektin, datën dhe orën e inspektimit të përbashkët, në zbatim të Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm me nr. 6, datë 16.01. 2023, “Për kryerjen dhe bashkërendimin e inspektimeve për mbrojtjen e shëndetit nga produktet e duhanit”.

## **Inspektorati Qendror ushtron aktivitetin bashkërendues në fushën e inspektimit, por inspektoratet shtetërore nuk sigurojnë përputhshmëri midis programit mujor të inspektimit shkresor me atë elektronik.**

Megjithatë, bazuar në raportet e mbikëqyrjes për këto inspektorate për periudhën kohore Janar 2021 - Dhjetor 2023 janë evidentuar problematika të ndryshme të ngritura lidhur me respektimin e afateve ligjore për dërgimin e programeve vjetore të inspektimit, pasi jo gjithmonë inspektoratet shtetërore i dërgojnë brenda afateve të përcaktuara nga VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e - Inspektimi” Gjithashtu, po në këtë kontekst vërehet se, përgjithësisht programimi i veprimtarisë inspektuese nga inspektoratet shtetërore nuk është zbatuar në përputhje me programin fillestar të dërguar në IQ për mendim këshillimor, pasi vërehet një numër i lartë inspektimesh të paprogramuara. Si për shembull, në rastin e Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, në të cilën evidentohet se në 39 subjekte nuk është kryer procedura inspektuese e programuar, si dhe janë programuar në sistemin e - Inspektimi 145 subjekte të tjera të pa paraqitura më parë.<sup>24</sup>

Më konkretisht vlerat totale të inspektimeve të realizuara pa mendim këshillimor nga inspektoratet shtetërore duke devijuar nga programet mujore referuar të dhënave të hedhura në programin “e – Inspektimi” janë si më poshtë:

---

<sup>24</sup> Raporti i Mbikëqyrjes i Drejtorisë së Shërbimit të Peshkimit dhe Akuakulturës, faqe 3, viti 2023. Kjo e dhënë nuk është dhëna e kumulative e të gjithë vitit 2023.

Tabela 5 Devijimet nga programet mujore në numër inspektimesh

Inspektorate Shtetërore	Nr. Inspektimesh (subjektesh) realizuar pa mendim këshillimor të IQ - së		
	2021	2022	2023
ISHMT	391	482	173
AKM	0	0	186
AKU	0	2790	907
IKMT	0	108	12
ISHTI	115	108	197
ISHPSHSH	0	1230	661
DSHPA	63	108	277

Burimi: IQ

Përpunoi: GA

Pra programet e inspektimit të hedhura në sistemin “e – Inspektimi”, jo gjithmonë përputhen me ato që inspektoratet shtetërore dërgojnë për mendim pranë IQ-së. Kjo është një situatë e ripërsëritur pasi, në vijimësi, Inspektorati Qendror në raportet e përgjithshme të inspektimit apo edhe në raportet e mbikëqyrjes specifike për inspektoratet shtetërore gjithmonë ka rekomanduar që të ketë përputhje të plotë midis programit shkresor dhe atij të hedhur në sistemin elektronik ISH – të, duke shmangur kështu devijime të panevojshme në zbatimin e programit mujor të inspektimit.

### **Inspektorati Qendror ka hartuar dhe miratuar metodologjitë dhe rregullat për ushtrimin e funksioneve inspektuese, por nuk ka përditësuar Manualin e Përgjithshëm të Inspektimit**

Inspektorati Qendror në zbatim të ligjit për inspektimet të vitit 2011, ka hartuar në vite aktet e nevojshme metodologjike në fushën e inspektimit, duke përfshirë këtu metodologjinë për vlerësimin e riskut, programimin e inspektimeve si dhe raportimin e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore etj. Hartimi i këtyre dokumenteve ka rregulluar procedurën inspektuese duke përdorur si reference standardet ndërkombëtare të OECD - së, e cila bazohet në analizat dhe praktikat më të mira në politikat publike në fushën e inspektimit. Në disa raste hartimi dhe miratimi i rregullave të përgjithshme është bërë edhe nga ministritë e linjës, si në rastin e ISHTI – t së inspektorateve shtetërore si për shembull: Rregullat e përgjithshme për shqyrtimin e ankesave, nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Matrica e dënimeve administrative të Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore; Rregullorja për metodologjinë mbi caktimin e masave administrative, ISHMT; Udhëzimet për dënimet administrative që përdoret nga ZMR (për mendim të IQ); Urdhri nr. 254, datë 11.8.2023, ”Për miratimin e përmbajtjes dhe modeleve të akteve për kundërvajtjet në pyje”. Megjithatë është evidentuar gjatë auditimit se Manuali i Përgjithshëm i Inspektimit nuk është përditësuar asnjëherë nga miratimi i tij në vitin 2015. Sipas parashikimeve të vet manualit, Inspektorati Qendror bashkëpunon me inspektoratet shtetërore dhe vendore dhe bën rishikimin dhe përditësimin e këtij manuali. Ky hap është i rëndësishëm pasi siguron që metodologjia dhe procedurat e inspektimit të mbeten në pajtueshmëri me praktikat më të mira dhe të pasqyrojnë ndryshimet në kuadrin ligjor dhe atë të inspektimit.

### **Inspektorati Qendror ka miratuar kriteret e arsimimit për pozicionet e punës “inspektor”, por inspektoratet shtetërore jo gjithmonë i kanë respektuar këto kriteret.**

Bazuar në ligjin nr. 10433/2011 për inspektimin, Inspektorati Qendror nuk ka kompetenca të drejtë për drejta në rregullimin e marrëdhënieve të punës të inspektorëve shtetërore. Sistemi aktual i marrëdhënieve të punësimit në inspektoratet shtetërore funksionon sipas dy regjimeve të ndryshme juridike: së pari, në ISH të ndryshme një pjesë e inspektorëve janë të punësuar

sipas Kodit të Punës dhe një pjesë sipas legjislacionit për statusin e nëpunësit civil, duke krijuar një mungesë kohezioni në mënyrën se si trajtohen inspektorët. Pra në këtë situatë, rekrutimi i inspektorëve realizohet pjesërisht nga vet inspektoratet shtetërore për pozicionet e punës që rregullohen me Kodin e Punës dhe një pjesë nga Departamenti i Administratës Publike për ato pozicione që janë të shërbimit civil. Inspektorati Shtetëror në këtë drejtim, ka përgjegjësi për pjesën e trajnimit dhe testimin të inspektorëve që punësohen sipas kodit të punës. Kjo situatë ka sjellë në vite një mungesë harmonizimi dhe pa mundësi për të siguruar profesionalizmin e përshtatshëm të trupës inspektuese.

Pra sikurse është parashtruar më sipër, Inspektorati Qendror, në bazë të ligjit të inspektimit, bën trajnimin dhe testimin fillestar dhe periodik të inspektorëve, të cilët rekrutohen sipas procedurave të Kodit të punës, bazuar kjo në Udhëzimin e Inspektorit të Përgjithshëm nr. 1 prot., datë 25.02.2020 “Programi i Trajnimit, për Testimin Fillestar dhe Periodik të Inspektorit Shtetëror të Republikës së Shqipërisë”. Për këtë qëllim janë hartuar dhe modulet e trajnimit për inspektoratet që i nënshtrohen trajnimit. Programi i Trajnimit, për Testimin Fillestar të Inspektorit të Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor; Programi i Trajnimit, për Testimin Fillestar dhe Periodik të Inspektorit Shtetëror të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit; Programi i Trajnimit, për Testimin Fillestar dhe Periodik të Inspektorit të Agjencisë Kombëtare të Barnave dhe Pajisjeve Mjekësore; Programi i Trajnimit, për Testimin Fillestar dhe Periodik të Inspektorit të Inspektoratit Shtetëror Teknik Industrial.

Sa i takon detyrimin ligjor që ka Inspektorati Qendror për hartimin dhe miratimin e kërkesave specifike për arsimimin e inspektorëve shtetërore/vendore dhe strukturat e tjera inspektuese, ka rezultuar se institucioni ka nxjerrë urdhrin nr. 6, datë 19.01.2021, “Për hartimin dhe miratimin e kërkesave specifike për arsimimin e Inspektorëve shtetërore/vendore dhe strukturat e tjera inspektuese”, me anë të së cilit ka rregulluar vetëm kriteret e arsimimit për ato inspektorate shtetërore ku marrëdhënia e punës rregullohet me kodin e punës, të cilët janë: AKU, ISHTI, ISHSH, AKNPM, IKMT dhe AKAP. Për ISH, ku marrëdhënia e punësimit rregullohet me statusin e nëpunësit civil kriteret e arsimit nuk janë në kompetencë të IQ, sikurse edhe në rastin e njësisve të vetëqeverisjes vendore që i rregullojnë këto pozicione pune me statusin e nëpunësit civil.

Pavarësisht kriterëve të miratuara, për pozicionin e punës “inspektor” janë gjetur raste ku inspektori i punësuar nuk përmbush kriterit e arsimit në përputhje me aktin e miratuar nga Inspektorati Qendror, gjë e cila ka sjellë si pasojë mos marrjen pjesë në procesin e testimin fillestar në periudhë prove.

Më konkretisht, për periudhën 2021 - 2023 janë evidentuar mospërputhje specifike në rastet si më poshtë<sup>25</sup>:

#### **- Inspektorati Shtetëror Teknik Industrial**

Për vitin 2023, nga gjithsej 89 inspektorë, janë konstatuar 6 raste punësimi ku kriteret specifike të arsimimit nuk përputheshin. Këta inspektorë nuk kanë të drejtë të jenë pjesë e trajnimit dhe testimin fillestar, gjë që sjell mos pajisjen e tyre me kartë inspektori.

#### **- Inspektorati Shtetëror Shëndetësor**

Për periudhën kohore 2021 – 2023, nga gjithsej 245 inspektorë janë evidentuar 5 inspektorë, që nuk përmbushin kriteret përkatëse të arsimimit të kërkuara për pozicionet e tyre, të cilët nuk mund të jenë pjesë e trajnimit dhe testimin fillestar në periudhë prove, gjë që sjell mos pajisjen e tyre me kartë inspektori.

#### **- Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit**

Me shkresën nr. 319/19 prot., datë 14.10.2022, me temë “Për zbatim, mbi kriteret specifike të arsimimit të inspektorëve shtetërore në detyrë”, nga gjithsej 506 inspektorë, janë konstatuar 22

---

<sup>25</sup> Të dhënat specifike të IQ - së janë përfshirë në Aneksin 2 të këtij raporti auditimi.

pozicione pune, ku të punësuarit nuk plotësojnë kriteret e nevojshme të arsimimit, sipas kriterëve të miratuara nga Inspektorati Qendror.

#### **- Autoriteti Kombëtar i Ushqimit**

Me shkresën nr. 27/12 prot., datë 05.08.2022, me temë “Për zbatim, mbi kriteret specifike të arsimimit të inspektorëve shtetërorë të AKU”, nga gjithsej 337 inspektorë, janë konstatuar 9 pozicione pune, ku të punësuarit nuk plotësojnë kriteret e nevojshme të arsimimit, sipas kriterëve të miratuara nga Inspektorati Qendror.

IQ ka kërkuar vazhdimisht që inspektoratet shtetërorë të marrin masa në përputhje me Kodin e Punës për të rregulluar mospërputhjet me kriteret e arsimimit për të siguruar që vetëm personat me arsim të përshtatshëm për detyrën të vazhdojnë të jenë në pozicionet përkatëse.

#### **Inspektorati Shtetëror ka kryer mbikëqyrjen e ligjit nr. 10433/2011 sipas kompetencave ligjore për inspektoratet shtetërore**

Procesi i mbikëqyrjes planifikohet me qëllim që ai të kryhet për të adresuar dhe përmirësuar veprimtarinë inspektuese dhe identifikimin e elementëve të profilit të riskut të inspektorateve shtetërore/trupave të tjera inspektuese. Për këtë IQ planifikon çdo vit veprimtarinë mbikëqyrëse të inspektorateve shtetërorë/trupa të tjera inspektuese, në planin vjetor të punës, i cili miratohet nga Inspektori i Përgjithshëm. Mbikëqyrja e veprimtarisë inspektuese kryhet mbi bazë të planifikimit, por edhe mbi bazë tematike. Mbikëqyrja me bazë tematike iniciohet nga Inspektori i Përgjithshëm, me kërkesë të një palë të tretë/ankesë. Procesi i mbikëqyrjes përfshin planifikimin, hartimin e raportit paraprak, raportin e mbikëqyrjes, si dhe zbatimin e rekomandimeve. Raporti paraprak hartohet bazuar në rezultatet e gjetjeve dhe analizën e tyre, ku përmban informacion mbi gjetjet e tij dhe rekomandimet, si dhe duhet ti paraqitet subjektit të kontrolluar brenda dy javësh nga data e përfundimit të tij. Autoritetet/personat përgjegjës, të cilët kanë kundërshtime për gjetjet, paraqesin me shkrim arsyetimet e tyre, duke bashkëlidhur çdo fakt ose dokument që provon këtë arsyetim. Përgjigja duhet ti paraqitet zyrtarisht Inspektoratit Qendror brenda 10 ditësh nga dorëzimi i raportit paraprak.

Mbikëqyrësi i ISH - ve, sipas ndarjes së punës, duhet të komentojë me shkrim, çdo kundërshtim të të kontrolluarve mbi gjetjet e mbikëqyrjes. Komentet paraqiten në Raportin Përfundimtar, në çdo rast në fund të trajtimit të gjetjes. Mbikëqyrësi do të komentojë shkurt qëndrimin e tij aprovues ose kundërshtues ndaj vërejtjes së të kontrolluarit, duke dhënë argumente të bazuara për secilin opsion. Gjetjet që mbikëqyrësi i gjen të kontestuara në mënyrë të argumentuar dhe të faktuara nga ana e tyre, nuk i paraqet në Raportin Përfundimtar. Raporti Përfundimtar i mbikëqyrjes, është dokumenti përfundimtar i cili paraqet gjithë informacionin e duhur mbi procesin e kryerjes së veprimtarisë inspektuese nga ISH/trupat e tjera inspektuese të mbikëqyrura, si dhe rekomandimet përkatëse dhe planin e veprimit për përmbushjen e rekomandimeve të lëna nga IQ. Raporti Përfundimtar i Mbikëqyrjes i përcillet subjektit të kontrolluar zyrtarisht nga Inspektori i Përgjithshëm i IQ, përgjithësisht brenda dy javësh nga marrja e komenteve nga subjekti i kontrolluar. Raportit vjetor të mbikëqyrjes i nënshtrohen të gjitha inspektoratet shtetërore. Mbikëqyrja kryhet kryesisht nëpërmjet sistemit “e-Inspektimi”, i cili disponon çdo të dhënë për procedurën inspektuese.

Inspektorati Qendror, brenda kompetencave të tij ligjore, ka mbikëqyrur edhe procedurën e ankimit, duke dhënë mendimin e tij për këtë procedurë në Raportet e mbikëqyrjes për çdo inspektorat. Procedura e Ankimit është pjesë e sistemit online të inspektimeve dhe nëpërmjet saj mund të mbikëqyret plotësimi i afateve të ankimit dhe të shqyrtimit të ankesave. Në sistemin “e-Inspektimi” në çdo çështje inspektimi, nëse ka pasur ankim nga subjekti, si dhe ankim të veçantë, inspektori e ka detyrim ta bëjë pjesë të dosjes elektronike të inspektimit, si dhe marrjen e Vendimit përfundimtar nga Komisioni i Shqyrtimit të ankimit. Për këtë proces, ka rezultuar se jo të gjitha inspektoratet shtetërore e plotësonin procesin në të gjitha hallkat e

tij, sa i përket ankimit të subjektit të inspektimit, vendimit të trupës kolegjiale apo vendimit të gjykatës administrative.

**1. Gjetje nga auditimi:** Inspektorati Qendror ushtron aktivitetin bashkërendues në fushën e inspektimit, por inspektoratet shtetërore nuk sigurojnë përputhshmëri midis programit mujor të inspektimit shkresor me atë elektronik. Vërehet se, përgjithësisht programimi i veprimtarisë inspektuese nga inspektoratet shtetërore nuk është zbatuar në përputhje me programin fillestar të dërguar në IQ për mendim këshillimor, pasi është evidentuar një numër i lartë inspektimesh të paprogramuara. Më konkretisht vlerat totale të inspektimeve të realizuara pa mendim këshillimor nga inspektoratet shtetërore duke devijuar nga programet mujore referuar të dhënave të hedhura në programin “e – Inspektimi” sipas viteve janë 569 për vitin 2021, 4826 për vitin 2022 dhe 2413 për vitin 2023, paraqitur në tabelën më poshtë poshtë:

Tabela 6 Devijimet nga programet mujore në numër inspektimesh

Inspektorate Shtetërore	Nr. Inspektimesh (subjektesh) realizuar pa mendim këshillimor të IQ - së		
	2021	2022	2023
ISHMT	391	482	173
AKM	0	0	186
AKU	0	2790	907
IKMT	0	108	12
ISHTI	115	108	197
ISHPSHSH	0	1230	661
DSHPA	63	108	277
<b>TOTAL</b>	<b>569</b>	<b>4826</b>	<b>2413</b>

Burimi: IQ,

Përpunoi: GA

Nga ana e tij, Inspektorati Qendror në raportet e përgjithshme të inspektimit apo edhe në raportet e mbikëqyrjes specifike për inspektoratet shtetërore gjithmonë ka rekomanduar që të ketë përputhje të plotë midis programit shkresor dhe atij të hedhur në sistemin elektronik nga ISH – të, për të shmangur devijime të panevojshme në zbatimin e programit mujor të inspektimit.

**2. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit është konstatuar se Inspektorati Qendror ka hartuar dhe miratuar metodologjitë dhe rregullat për ushtrimin e funksioneve inspektuese, por nuk ka përditësuar Manualin e Përgjithshëm të Inspektimit që nga miratimi i tij në vitin 2015. Sipas parashikimeve të vet Manualit, Inspektorati Qendror bashkëpunon me inspektoratet shtetërore dhe vendore dhe bën rishikimin dhe përditësimin e këtij manuali. Ky hap është i rëndësishëm pasi siguron që, metodologjia dhe procedurat e inspektimit të mbeten në pajtueshmëri me praktikat më të mira dhe të pasqyrojnë ndryshimet në kuadrin ligjor dhe atë të inspektimit.

**3. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimit, inspektoratet shtetërore jo gjithmonë kanë respektuar këto kriteret e arsimimit për pozicionet e punës “inspektor”, sipas miratimeve të Inspektoratit Qendror. Sipas në ligjin nr. 10433/2011 për inspektimin, Inspektorati Qendror nuk ka kompetenca të drejtë për drejta në rregullimin e marrëdhënieve të punës të inspektorëve shtetërore, por ka detyrimin ligjor për të hartuar dhe miratuar kërkesat specifike për arsimimin e inspektorëve shtetërore/vendore dhe strukturat e tjera inspektuese. Në këtë drejtim, IQ ka nxjerrë urdhrin nr. 6, datë 19.01.2021, “Për hartimin dhe miratimin e kërkesave specifike për arsimimin e Inspektorëve shtetërore/vendore dhe strukturat e tjera inspektuese”, me anë të së

cilit ka rregulluar vetëm kriteret e arsimimit për ato inspektorate shtetërore ku marrëdhënia e punës rregullohet me kodin e punës, të cilët janë: AKU, ISHTI, ISHSH, AKNPM, IKMT dhe AKAP. Për ISH, ku marrëdhënia e punësimit rregullohet me statusin e nëpunësit civil kriteret e arsimit nuk janë në kompetencë të IQ, sikurse edhe ato njësi të vetëqeverisjes vendore që i rregullojnë këto pozicione pune me statusin e nëpunësit civil.

Pavarësisht kriterëve të miratuara, për pozicionin e punës “inspektor” janë gjetur raste të mos përmbushjes së kriterit e arsimit në përputhje me aktin e miratuar nga Inspektorati Qendror, gjë e cila ka sjellë si pasojë mos marrjen pjesë në procesin e testimit fillestar në periudhë prove. Më konkretisht, për periudhën 2021 - 2023 janë evidentuar mospërputhje specifike si më vijon<sup>26</sup>: 6 raste (nga 89 inspektor gjithsej) në Inspektoratin Shtetëror Teknik Industrial; 5 raste (nga 245 inspektor gjithsej) në Inspektoratin Shtetëror Shëndetësor; 22 raste (nga 506 inspektor gjithsej) në Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit; 9 raste (nga 337 inspektor gjithsej) në Autoritetin Kombëtar të Ushqimit.

**Konkluzion 1:** Nga ana e tij, Inspektorati Qendror në raportet e përgjithshme të inspektimit apo edhe në raportet e mbikëqyrjes specifike për inspektoratet shtetërore gjithmonë ka rekomanduar që të ketë përputhje të plotë midis programit shkresor dhe atij të hedhur në sistemin elektronik nga ISH – të, për të shmangur devijime të panevojshme në zbatimin e programit mujor të inspektimit.

**Konkluzion 2:** Mos rishikimi i Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit sipas një qasjeje gjithëpërfshirëse mund të cenojë përputhshmërinë me praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e inspektimit.

**Konkluzion 3:** Mos respektimi i kriterëve të arsimimit për pozicionet e punës inspektor nuk ka kontribuar në konsolidimin e profesionalizmit të trupës inspektuese në inspektoratet shtetërore.

**1.1 Rekomandim:** Inspektorati Qendror (i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm), në kuadër të rishikimit të bazës nën ligjore që do të rregullojë sistemin “e – Inspektimi”, brenda kompetencave që i janë caktuar nga ligji i ri për inspektimet nr. 99/2024, të parashikojë dispozita specifike në garantim të përputhshmërisë së plotë midis programeve mujore të inspektimeve shkresore dhe elektronike.

*Brenda datës 31.12.2025*

**2.1 Rekomandim:** Inspektorati Qendror (i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm), të rishikojë Manualin e Përgjithshëm të Inspektimeve në kuadër të ndryshimeve të reja ligjore, për sigurimin e ushtrimit të funksioneve inspektuese, duke ju referuar edhe praktikave më të mira në këtë fushë.

*Brenda datës 31.12.2025*

**3.1 Rekomandim:** Inspektorati Qendror (i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm) në kuadër të rikonceptimit të funksioneve inspektuese me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 99/2024, të kryejë një vlerësim paraprak në lidhje me kriteret e arsimimit për trupën inspektuese sipas fushave të inspektimit, duke patur parasysh që pranë këtij institucioni do të ngrihet dhe funksionojë Komisioni i rekrutimit dhe ecurisë në karrierë.

*Brenda datës 31.12.2025*

---

<sup>26</sup> Të dhënat specifike të IQ - së janë përfshirë në Aneksin 2 të këtij raporti auditimi.

### 5.3 A i kanë ushtruar kompetencat e tyre sipas akteve ligjore dhe nënligjore inspektoratet shtetërore dhe vendore?

Në kuadër të kryerjes së funksioneve inspektuese nga inspektoratet shtetërore, gjatë këtij auditimi, janë evidentuar problematika të ndryshme, të cilat kryesisht kanë të bëjnë me mënyrën se si inspektoratet shtetërore që përdorin sistemin “e-Inspektimi” ushtrojnë funksionet inspektuese. Përgjithësisht, sipas raporteve të mbikëqyrjes të IQ – së të vitit 2023, për inspektoratet shtetërore, evidentohet se problematikat kryesore i përkasin mungesës së dokumentacionit apo të dhënave, shkeljeve të legjislacionit, mospërputhjes së të dhënave dhe mosrespektimit të afateve sipas parashikimeve ligjore/rregullatore. Për këto problematika në raportet e mbikëqyrjes së kryera nga IQ janë evidentuar në formë tabelare një pjesë e rasteve të konstatuara prej tyre, pa përfshirë faktin se këto fenomene janë të përhapura dhe evidentohen gjerësisht gjatë procesit të mbikëqyrjes që ushtrohet nga IQ. Lidhur me sa më sipër, në vijim është shtjelluar më konkretisht cilat kanë qenë fenomenet e përfshira për secilën kategori problematikash, të identifikuar nga IQ, si dhe numri i rasteve të evidentuara.

#### ➤ Mungesë dokumentacioni/të dhënash

Përgjithësisht, inspektoratet shtetërore, nuk bashkëlidhin dokumentacion të plotë dhe të saktë për inspektimet, veçanërisht për njoftimet, kërkesat e shtyrjes dhe arsyet e realizimit të inspektimeve jashtë programit etj.

- përgjithësisht kur kryen inspektime jashtë programi, ISH – të nuk bashkëlidhin dokumentacion për inicimin e kësaj procedure.

- në disa raste nuk është bashkëlidhur në dosjen elektronike dokumentacioni i shqyrtuar apo i cituar në listë verifikimi dhe procesverbal.

- në sistemin “e – Inspektimi” nuk pasqyrohet ecuria e masës administrative (ankimuar ose jo, paguar/papaguar, data e pagesës dhe kësti).

- në shumë raste, kur inspektimi realizohet me njoftim paraprak, nuk dokumentohet njoftimi i autorizimit. Kur inspektimi autorizohet jashtë programit, në dosje nuk bashkëlidhet dokumentacioni për arsyen e realizimit të kësaj procedure inspektimi.

- në disa procedura inspektuese nuk ngarkohet me dokumente justifikuese si foto/dokumente të marra gjatë procesit inspektues.

- në dokumentin “Procesverbal Inspektimi”, në disa raste, në rubrikën “gjetjet e konstatuara”, nuk pasqyrohen në mënyrë të detajuar konstatimet/shkeljet në subjektin e inspektuar nga ana e inspektorëve, si dhe nuk pasqyrohet koha reale e inspektimit, pasi nga GPS rezulton se vendimi përfundimtar është gjeneruar më herët se ora e përfundimit të inspektimit që pasqyrohet në procesverbal.

- në disa raste të tjera, në të cilat është marrë mostër për analize të produkteve referuar planit të marrjes së mostrave për analizë, nuk dokumentohen rezultatet e Raportit të Provave në dosjen e inspektimit në mosrespektim të kërkesave ligjore.

Bazuar në raportet e mbikëqyrjes të IQ – së të vitit 2023, inspektoratet shtetërore kanë pasur problematika lidhur me mungesën e dokumentacionit/të dhënave (në numër të përafërt rastesh) si më poshtë:

Tabela nr. 7: Numër rastesh

Mungesë dokumentacioni/të dhënash (nr rastesh)	Inspektorate
+ 12	AKBPM
+ 11	AKSEM
+ 8	AKMC
+ 103	AKU
+ 26	DSHPA
+ 20	ISHSH

+ 15	ISHMT
+ 3	ZMR
+ 8	ISHTI
+ 25	AKM
+ 3	SHPSHSH
+ 2	DPA
+ 44	IKMT
+ 7	AKB

Burimi: IQ,

Përpunoi: GA

### ➤ Mospërputhje në të dhëna

Ka mospërputhje të vazhdueshme mes datave të caktuara për inspektime, njoftime dhe vendime përfundimtare:

- në disa raste të inspektimeve të autorizuara për depo farmaceutike apo depo të pajisjeve mjekësore, inspektimi nuk realizohet me argumentin se subjekti “gjendet i mbyllur” apo “subjekti nuk gjendet/ekziston” në adresën e deklaruar në QKB. Nga verifikimi i historikut të disa prej subjekteve, por edhe të ekstraktit historik në QKB, rezulton se këto subjekte kanë vite të regjistruara në QKB, kanë statusin aktiv e kanë bërë veprime në vitin 2023, si dhe nuk kanë ndryshuar adresë.

- në shumë çështje inspektimi ku në zbatim të ligjit për inspektimin, objekti duhet të përcaktojë qëllimin e inspektimit, ka rezultuar se objekti nuk është i saktë ose është i përgjithshëm si për shembull "Zbatim i legjislacionit" ose "Kontroll i programuar".

- në disa raste, ka mospërputhje midis deklarimeve të inspektorëve në procesverbal për fillimin dhe mbarimin e inspektimit në subjekt dhe mbajtjes së procesverbalit në sistem.

- ka raste kur procedura realizohet para apo pas kohëzgjatjes së deklaruar dhe nuk argumentohet arsyeja.

- në shumë raste, në rubrikën gjetje në procesverbal nuk pasqyrohen të gjitha shkeljet e konstatuara në listë verifikimi, shkelje këto për të cilat ligji parashikon masë administrative gjobë apo masa të tjera.

- në disa raste, ka mospërputhje mes deklarimeve të inspektorëve, për sa i përket vendit të inspektimit, dhe gjurmimit në sistem, ku procesverbali dhe listë verifikimi nuk mbahen në adresën e subjektit objekt inspektimi.

Bazuar raporteve të mbikëqyrjes të IQ – së të vitit 2023, inspektoratet shtetërore kanë pasur problematika lidhur me mospërputhjen e të dhënave (në numër të përafërt rastesh) si më poshtë:

Tabela nr. 8: Numër rastesh

Mospërputhje në të dhëna (nr rastesh)	Inspektoriate
+ 6	AKBPM
+ 16	AKSEM
+ 2	AKMC
+ 62	AKU
-	DSHPA
+ 13	ISHSH
-	ISHMT
-	ZMR
+ 6	ISHTI
+ 9	AKM
+ 11	SHPSHSH
+ 3	DPA



+ 2	IKMT
+ 6	AKB

Burimi: IQ,

Përpunoi: GA

### ➤ Shkelje të procedurave ligjore

Procesi i inspektimit në kuptimin e ligjit nr. 10433/2011 është proces i natyrës administrative, i cili nis me njoftimin e inspektimit e vijon me hapat e tjera inspektuese të diktuar nga ligji, nga VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e – Inspektimi”, si edhe urdhrat dhe udhëzimet e miratuara nga IQ, në veçanti sa i takon respektimit të formateve përkatëse të dokumenteve standarde të procesit të inspektimit, procesverbalet, listat e verifikimeve, vendimet etj.

Referuar rezultateve të mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit të kryera nga IQ, janë evidentuar shkelje të natyrës procedurale në këtë drejtim, në veçanti sa i takon pamundësisë për të gjurmuar me anë të GPS nëse inspektimi është kryer në adresën e deklaruar të subjektit sikur është përcaktuar në autorizimin e inspektimit. Kjo do të thotë që Lista e Verifikimit (LV) dhe Procesverbali i inspektimit (PV) si dhe hapa të tjerë të lidhur me procesin e inspektimit nuk janë mbajtur në vendin dhe momentin e kryerjes së inspektimit, duke rënë ndesh kështu me përcaktimin ligjor (neni 33 dhe 43 i ligjit nr. 10433/2011), i cili vendos pikërisht këtë kriter. Pra, vendi i inspektimit mund të jetë kudo ku kryen veprimtarinë subjekti i inspektimit, pasi edhe procesverbali i inspektimit mbahet pikërisht në vendin e përcaktuar në autorizimin e inspektimit ku subjekti ushtron aktivitetin e tij.

Gjithashtu, në këto raporte evidentohet se në sistemin “e-Inspektimi”, ka raste kur nuk administrohen të nënshkruara dhe vulosura nga Kryeinspektori autorizimi dhe marrja e njoftimit të autorizimit sikundër parashikohet në nenin 27 të ligjit nr. 10433/2011. Kur bëhet fjalë për inspektime pa njoftim paraprak, në autorizimet përkatëse nuk përcaktohet qartë arsyeja e mos njoftimit paraprak, gjë kjo e cila është detyrim që rrjedh nga ligji nr. 10443/2011, si dhe nga legjislacione të tjera specifike në fushën e inspektimit. Sa i takon kohëzgjatjes së inspektimit e cila duhet të përfshihet në autorizimin e inspektimit shpesh herë ajo nuk deklarohet/llogaritet saktë sipas përcaktimeve të pikës 5, neni 29 të ligjit 10433/2011.

Gjatë mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit janë vërejtur edhe problematika lidhur me plotësimin e duhur të dokumenteve sipas standardeve të miratuara nga IQ, si për shembull:

- dokumentet standarde të inspektimit nuk nënshkruhen nga subjekti i inspektimit;
- në procesverbalin e inspektimit nuk evidentohen qartë veprimet e kryera gjatë procesit inspektues, për të argumentuar vendimmarrjen në fund të procedurës.
- në procesverbalin e inspektimit, citohet gabim baza ligjore për klasifikimin e shkeljes së konstatuar dhe për klasifikimin e kundërvajtjes administrative;
- në procesverbalin e inspektimit nuk jepet arsyeja e përfundimit të inspektimit, kur nuk gjenden shkelje të kërkesave ligjore.

Edhe vendimet e inspektimeve, nga të dhënat e raporteve të mbikëqyrjes së ligjit, paraqesin problematika, pasi shpesh herë në vendimin përfundimtar të inspektimit nuk përshtrohet baza ligjore e shkelur, por vetëm baza ligjore për ndëshkimin e shkeljes, pra ajo e masës administrative të marrë, si dhe vendoset masa administrative “gjobë” pa argumentuar arsyen e aplikimit të saj.

Në këto situata, pra në mungesë të arsytimit ligjor në mbështetje kundërvajtjes administrative drejtuar subjektit, vërehet se, në përcaktimin e ndëshkimit në Vendimin përfundimtar të inspektimit, inspektorët nuk respektojnë parimet bazë të inspektimit, kryesisht atë të pavarësisë së inspektorit, pasi për të njëjtën shkelje nuk jepet e njëjta masë administrative.

Bazuar raporteve të mbikëqyrjes të IQ – së të vitit 2023, inspektoratet shtetërore kanë pasur problematika lidhur me shkeljen e procedurave ligjore (në numër të përafërt rastesh) si më poshtë:

Tabela nr. 9: Numër rastesh

Shkelje të procedurave ligjore (nr rastesh)	Inspektoriate
+ 4	AKBPM
+ 18	AKSEM
+ 29	AKMC
+ 246	AKU
+ 87	DSHPA
+ 224	ISHSH
+ 22	ISHMT
-	ZMR
+ 51	ISHTI
+ 31	AKM
+ 145	ISHPSHSH
-	DPA
+ 219	IKMT
+ 33	AKB

Burimi: IQ,

Përpunoi: GA

➤ **Mosrespektimi i afateve:**

Në shumë raste, nuk respektohen afatet ligjore për paraqitjen e shpjegimeve nga subjektet ose për procedurat e ankimit.

- në disa raste vendimi përfundimtar i inspektimit merret brenda të njëjtës datë të mbajtjes së procesverbalit, në kundërshtim me pikën 4, të nenit 45 të ligjit për inspektimin ku përcaktohet se subjekti paraqet me shkrim apo me gojë shpjegimet apo kontestimet e tij për faktet dhe rrethanat e konstatuara në procesverbal, brenda një afati të përcaktuar nga inspektori, por jo më të shkurtër se 8 ditë nga data e njoftimit të procesverbalit.

- Ka raste kur procedura e inspektimit kryhet jashtë kohëzgjatjes së përcaktuar në autorizim në kundërshti me parashikimet në pikat, 1 dhe 4 të nenit 29, të ligjit 10433/2011.

- Ka mospërputhje me kohëzgjatjen e inspektimit të deklaruar në listë verifikimin me kohëzgjatjen e përcaktuar në procesverbal

- në disa raste, rubrika "Kohëzgjatja e inspektimit", ora e fillimit, ora e mbarimit) nuk plotësohet në përputhje me dokumentacionin standard dhe nenin 28, të ligjit për inspektimin. Bazuar raporteve të mbikëqyrjes të IQ – së të vitit 2023, inspektoratet shtetërore kanë pasur problematika lidhur me mosrespektimin e afateve (në numër të përafërt rastesh) si më poshtë:

Tabela nr. 10: Numër rastesh

Mosrespektimi i afateve (nr. rastesh)	Inspektoriate
+ 8	AKBPM
-	AKSEM
-	AKMC
+ 33	AKU
-	DSHPA
+ 44	ISHSH
-	ISHMT

-	ZMR
+ 6	ISHTI
+ 13	AKM
-	ISHPSHSH
-	DPA
+ 9	IKMT
+ 8	AKB

Burimi: IQ,

Përpunoi: GA

### Mbivendosje kompetencash midis inspektorateve në nivel qendror

Gjatë auditimit janë evidentuar raste mbivendosje të veprimtarisë inspektuese, në veçanti midis inspektorateve në nivel qendror, për shkak të mbivendosjes së kompetencave në fusha të caktuara. Këto mbivendosje janë evidentuar nga Inspektorati Qendror gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese, sidomos midis IKMT dhe AKM. Për këto fusha inspektimi, pra mjedis, pyje dhe ujëra është rritur barra administrative e biznesit, duke ndëshkuar një biznes me masë administrative njëjtën për të njëjtën shkelje nga më shumë se një inspektorat.

Kjo situatë ka ndodhur pasi, duke nisur nga viti 2019, me ndryshimet e VKM nr. 502, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme", Ministrisë së Brendshme i është shtuar në fushën e përgjegjësisë së vet edhe "parandalimi, mbrojtja, mbikëqyrja dhe kontrolli i zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.<sup>27</sup>" Këto përgjegjësi të reja të MB – së janë ushtruar nëpërmjet IKMT - së në cilësinë e insitucionit të varësisë përgjegjës për funksionet e inspektimit.

Me VKM nr. 604 datë 20.10.2021, "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Brendshme", i cili ka shfuqizuar VKM – në e sipër cituar, "parandalimi, mbrojtja, mbikëqyrja dhe kontrolli/inspektimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apondërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji" ka vijuar të mbetet në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme e për rrjedhojë këto funksione janë ushtruar nëpërmjet Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit. Duhet theksuar që po këto fusha janë edhe pjesë e mbikëqyrjes dhe inspektimit të ushtruar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në cilësinë e institucionit përgjegjës për inspektimin e kërkesave ligjore në fushën e mjedisit dhe ujërave.

Sa i takon rasteve të mbivendosjeve të kompetencave duhet evidentuar se ISH – të jo gjithmonë janë të saktë në plotësimin e fushave përkatëse të sistemit "e – Inspektimi" sa i takon objektit të inspektimeve.

Megjithatë nga të dhënat<sup>28</sup> e vendosura në dispozicion nga Inspektorati Qendror të nxjerra nga sistemi "e – Inspektimi" për periudhën 2022 – 6 mujori i parë 2024<sup>29</sup> (të dhënat analitike bashkëlidhur këtij raporti në Aneksin 1) rezultojnë rastet si më poshtë:

Tabela 11 Rastet e inspektimit në fushën e mjedisit dhe ujëra nga AKM dhe IKMT

Numër subjektsh të inspektuara në fushën e	2022	2023	6 Mujori 2024
		149 subjekte	132 subjekte

<sup>27</sup> Pika 3. Germa f, VKM nr. 502, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme" e ndryshuar.

<sup>28</sup> Të dhënat e plota për periudhën 2021 – 6 mujori i parë i vitit 2024 gjenden në Aneksin 1 të raportit të auditimit.

<sup>29</sup> Referuar përgjigjeve zyrtare të Inspektoratit Qendror, për vitin 2021 nuk janë konstatuar mbivendosje nga IQ në sistemin "e – Inspektimi".

<b>mjedisit dhe ujrave nga AKM dhe IKMT</b>			
---	--	--	--

Burimi: IQ

Përpunoi: GA

Pikërisht për këtë aspekt, bizneset i janë drejtuar shpesh herë me ankesa specifike institucioneve inspektuese, si edhe Inspektoratit Qendror, nga ku mund të veçojmë rastin e Shoqërisë Maksi Elektrik, e cila ka dërguar pranë Inspektoratit Qendror një ankesë në të cilën shprehet se dy institucione të ndryshme e kanë ndëshkuar me masë administrative “gjobë” për të njëjtën shkelje e konkretisht:

- IKMT ka konstatuar shkelje të ligjit nr. 111, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 41, pika 1, germa a, pasi subjekti ushtron veprimtari pa disponuar leje përdorimi uji nga organet e menaxhimit të burimeve ujore;

- ARM Berat, Elbasan, Korçë ka konstatuar se referuar ligjit nr. 111, datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, neni 41, pika 1, germa a dhe c, dhe nenit 97, pika 3, ka kundërvajtje administrative pasi subjekti nuk disponon lejen administrative të ujit të lëshuar nga AMBU (Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore).

Në këtë rast subjekti i është drejtuar me ankesë ARM – së Berat, Elbasan, Korçë (pasi ka inspektuar subjektin pas IKMT – së) për rishikimin e vendimit të inspektimit, pasi subjekti është inspektuar dhe ndëshkuar me parë me gjobë për të njëjtën shkelje nga IKMT, por ARM ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të inspektimit duke mos marrë parasysh pretendimet e subjektit. Në vijim, subjekti i është drejtuar me ankesë Inspektoratit Qendror, në cilësinë e institucionit që ka për detyrë bashkërendimin e veprimtarisë inspektuese duke kërkuar shfuqizimin e aktit administrativ. Në përgjigjen e tij drejtuar subjektit, Inspektorati Qendror shpjegon se nuk është institucion kompetent për këtë gjë. Pas shterimit të mjeteve ligjore administrative, IQ shpjegon se subjekti duhet t’i drejtohet gjykatës administrative kompetente. Sikurse kuptohet edhe nga rasti i më sipërm, problematika e mbivendosjes së kompetencave ka nxjerrë në pah edhe dobësi të tjera të lidhura me mënyrën se si zhvillohet procesi i ankimit pranë inspektorateve shtetërore, ku edhe në situata si ajo e mësipërme institucionet nuk marrin parasysh pretendimet e subjekteve.

Lidhur me procesin e ankimit pranë inspektorateve shtetërore, IQ, brenda kompetencave ligjore, ka mbikëqyrur procedurën e ankimit, duke dhënë mendimin e vet për këto procedurë në Raportet e mbikëqyrjes për çdo inspektorat. Procedura e Ankimit është pjesë e sistemit online të inspektimeve dhe nëpërmjet saj mund të mbikëqyret plotësimi i afateve të ankimit dhe të shqyrtimit të ankesave. Në sistemin “e-Inspektimi” në çdo çështje inspektimi, nëse ka pasur ankim nga subjekti, si dhe ankim të vecantë, inspektori e ka detyrim ta bëj pjesë të dosjes elektronike të inspektimit, si dhe marrjen e Vendimit përfundimtar nga Komisioni i Shqyrtimit të ankimit. Lidhur me këtë, për vitin 2023, IQ ka realizuar edhe mbikëqyrje tematike nga sistemi, ku kishte në fokus dokumentimin e procesit administrativ dhe gjyqësor të çështjeve të inspektimit të kryer. Nga kontrolli i kryer për këtë qëllim rezultoi se disa inspektorate shtetërore, nuk e plotësonin procesin në të gjitha hallkat e tij, sa i përket ankimit të subjektit të inspektimit, vendimit të trupës kolegjiale apo vendimit të gjykatës administrative. Për këtë, IQ i ka dërguar shkresa disa ISH-ve me lëndë “Tërheqje vëmendje mbi zbatimin e legjislacionit për inspektimin”, ku ka kërkuar përmirësimin e kësaj hallke të rëndësishme të inspektimit.<sup>30</sup>

Për sa më sipër, në kuadër të bashkërendimit dhe koordinimit të veprimtarisë inspektuese, IQ ka nxjerrë akte nënligjore me fokus të veçantë shmangien e mbivendosjeve të inspektimeve në kontrollin për mbrojtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e pyjeve, si më poshtë:

<sup>30</sup> Shkresa të Inspektoratit Qendror drejtuar respektivisht ISHMT, AKM, AKU, IKMT, ISHTI, AKB, AKBPM, ISHSH, ISHPSHSH me nr. 545 - 553 prot., datë 20.12.2023.

- Udhëzim nr. 17, datë 20.04.2023, “Për bashkërendimin e funksioneve inspektuese në fushën e pyjeve” i Inspektorit të Përgjithshëm të Inspektoratit Qendror, botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 70, të vitit 2023. Ky udhëzim u hartua me qëllim krijimin e kuadrit rregullator për bashkërendimin, harmonizimin dhe mbështetjen e veprimtarisë së inspektorateve shtetërore dhe vendore në fushën e inspektimit të pyjeve, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe ligjit 57/2020, datë 30.04.2020, “Për pyjet”.
- Urdhër nr. 29, datë 30.08.2023, “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe bashkërendimin në fushë veprimtarinë inspektuese të mjedisit”.
- Urdhër nr. 37, datë 13.11.2023, “Për kryerjen dhe bashkërendimin e inspektimeve të përbashkëta në fushën e mbrojtjes së pyjeve”.

### **Inspektoratet në nivel vendor ushtrojnë aktivitetin e inspektimit pa mbikëqyrje nga Inspektorati Qendror**

Sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore, funksionet e inspektimit në nivel vendor krijohen apo përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak të njësisë vendore përkatëse. Aktualisht në vendin tonë janë ngritur funksione inspektimi në 53 bashki duke mbuluar kryesisht:

- mbrojtjen e territorit (në 51 bashki)
- mjedisin, pyjet dhe kullotat (në 23 bashki)
- mbrojtjen e konsumatorit (në 2 bashki)
- mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimi (në 16 bashki)
- mbrojtjen civili (në 5 bashki)
- arsimin dhe shëndetësinë (në 3 bashki)
- veterinarinë dhe ushqimin (në 6 bashki)

Nga sa më sipër evidentohet se fusha e cila është mbuluar më tepër me funksione inspektimi është ajo e mbrojtjes së territorit, mjedisi, pyjet dhe kullotat, duke qenë se 51 nga 53 bashki kanë krijuar inspektorate të mbrojtjes së territorit (IMT) dhe 23 nga 53 kanë krijuar inspektorate që mbulojnë fushën e mjedisit, pyjeve dhe kullotave.

Në këtë drejtim njësitë vendore janë treguar aktive duke krijuar funksione inspektuese në përgjigje të nevojave specifike të territoreve që ato administrojnë.

Sa i takon mbarëvajtjes dhe harmonizimit të punës inspektuese në nivel vendor me atë në nivel qendror duhet theksuar, se nga ana e njësisë vendore ka munguar bashkëpunimi i duhur, kjo për shkak edhe të boshllëqeve të krijuara nga baza ligjore aktualisht në fuqi. Nga ana e vet, Inspektorati Qendror është përpjekur për të krijuar kushtet dhe shtyrë këto institucione për të përdorur sistemin on line të inspektimeve. Për këtë, në zbatim të Urdhrit të Inspektorit të Përgjithshëm nr. 26 prot., 07.03.20217, “Për miratimin e formateve standarde për dokumentimin e veprimtarisë së inspektimit për inspektoratet vendorë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në bashkëpunim me njësitë bashkiake është realizuar përshtatja e dokumenteve standarde të inspektimit dhe hartimi i listë verifikimit për çdo fushë inspektimi, si dhe implementimi i tyre në sistemin “e - Inspektimi”, për 61 bashkitë. Pavarësisht kësaj, asnjë nga inspektoratet vendore nuk e kryen inspektimin online në portalin “e – Inspektimi”. Në këtë drejtim duhet theksuar se VKM nr. 696, datë 16.08.2013 “Për përcaktimin e procedurave të ushtrimit të kompetencave të Inspektoratit Qendror dhe të rregullave për përmbajtjen dhe administrimin e portalit unik “e - Inspektimi” nuk ka përfshirë inspektoratet vendore si përdorues të këtij sistemi duke u kufizuar vetëm tek inspektoratet shtetërore.

Sikurse kemi përmendur edhe në paragrafin nr. 5.1, bashkërendimi dhe bashkëpunimi i deritanishëm midis inspektorateve vendore dhe Inspektoratit Qendror bazohet kryesisht në vullnetin e palëve, pasi inspektoratet vendore nuk kanë detyrime ligjore në këtë drejtim.

Nisur nga sa më sipër, inspektoratet vendore në praktikën e tyre të punës nuk dërgojnë programet vjetore/mujore të inspektimit pranë Inspektoratit Qendror për të siguruar kështu një

bashkërendim dhe harmonizim të punës inspektuese në territor, pasi ato nuk kanë një detyrim ligjor në këtë drejtim. Në Raportin e Përgjithshëm të Inspektimeve të vitit 2023, evidentohet se njësitë vendore nuk kanë përcjellë pranë Inspektoratit Qendror, informacion mbi lëvizjen e burimeve njerëzore në fushat e inspektimit që mbulon secila bashki, pavarësisht faktit se IQ sipas ligjit për inspektimet të vitit 2011, mban dhe përditëson Regjistrin e inspektorëve shtetërorë/vendorë në detyrë.

Në këtë drejtim është evidentuar se, sa i takon mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për inspektimet dhe legjislacioneve specifike sektoriale, aktualisht Inspektorati Qendror nuk e ka tagrin ligjor për të kryer këtë proces pranë inspektorateve vendore. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri nr. 99/2024 për inspektimet, kompetencat e Inspektoratit Qendror, i cili do të riorganizohet nën emërtimin Inspektorati i Përgjithshëm, janë zgjeruar dhe qartësuar kompetencat për sa më sipër, duke lejuar mbikëqyrje dhe bashkërendim të plotë.

Si rezultat i kësaj situatë, bashkërendimi i veprimtarive inspektuese midis inspektorateve shtetërore dhe atyre vendore është kryer nga IQ, vetëm në ato raste kur legjislacioni në fuqi dhe fusha e veprimtarisë inspektuese e lejojnë këtë bashkëpunim, si në rastin e IKMT dhe IMT në nivel vendor<sup>31</sup> në fushën e inspektimit të ndërtimeve të kundërligjshme. Në këtë rast, IQ ka hartuar procedurë inspektimi me dokumentacion standard dhe listë verifikimi për secilën prej tyre për të mos pasur mbivendosje kompetencash, por bashkëpunim. Të dyja trupat inspektuese janë trajnuar për procedurën inspektuese online, si IKMT dhe IMT, por asnjëra prej tyre nuk është përdorues i sistemit online të inspektimeve dhe e kryejnë procedurën jashtë sistemit online të inspektimit, gjë kjo e cila nuk favorizon shmangien e mbivendosjes së veprimtarisë inspektuese dhe koordinimin e saj.

**1. Gjetje nga auditimi:** Përgjithësisht, bazuar në raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit, inspektoratet shtetërore, gjatë kryerjes së funksioneve inspektuese kanë pasur problematika të ndryshme që lidhen me mungesën e dokumentacionit apo të dhënave të ndryshme të inspektimeve; mospërputhje në të dhënat e inspektimeve; shkelje të procedurave ligjore gjatë kryerjes së procesit të inspektimit si proces administrativ; mosrespektim të afateve etj. Sipas këtyre të dhënave për vitin 2023, këto fenomene kryesore të përmbledhura në numër të përafërt rastesh kanë rezultuar si më poshtë:

Tabela 12 Përmbledhëse e tipologjisë së mangësive

Inspektorate <sup>32</sup>		Mungesë dokumentacioni/të dhënash	Mospërputhje në të dhëna	Shkelje të procedurave ligjore	Mosrespektimi i afateve.
1	AKBPM	+12	+6	+4	+8
2	AKSEM	+11	+16	+18	-
3	AKMC	+8	+2	+29	-
4	AKU	+103	+62	+246	+33
5	DSHPA	+26	-	+87	-
6	ISHSH	+20	+13	+224	+44
7	ISHMT	+15	-	+22	-
8	ZMR	3	-	-	-
9	ISHTI	+8	+6	+51	+6
10	AKM	+25	+9	+31	+13

<sup>31</sup> Bashkërendimin e veprimtarive inspektuese midis IKMT dhe IMT në nivel vendor është kërkesë e ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar.

<sup>32</sup> Të dhënat janë të përafërta dhe bazohen në Raportet e Mbikëqyrjes së kryera nga IQ..

11	ISHPSHSH	+3	+11	+145	-
12	DPA	2	3	-	-
13	IKMT	+44	+2	+219	+9
14	AKB	+7	+6	+33	+8

Burimi: IQ

Përpunuar: GA

Për sa më sipër, duhet theksuar se nga raportet e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit del në pah se përgjithësisht këto fenomene janë të përhapura dhe evidentohen gjerësisht gjatë procesit të mbikëqyrjes që ushtrohet nga IQ.

**2. Gjetje nga auditimi:** Gjatë auditimit janë evidentuar raste të mbivendosjes së veprimtarisë inspektuese, në veçanti midis inspektorateve në nivel qendror, për shkak të mbivendosjes së kompetencave në fusha të caktuara. Këto mbivendosje janë evidentuar nga Inspektorati Qendror gjatë mbikëqyrjes së veprimtarisë inspektuese, sidomos midis IKMT dhe AKB. Për fushat e inspektimit mjedis, pyje dhe ujëra është rritur barra administrative e biznesit, duke ndëshkuar bizneset me masë administrative për të njëjtën shkelje nga më shumë se një inspektorat. Pikërisht për këtë aspekt, bizneset i janë drejtuar shpesh herë me ankesa specifike institucioneve inspektuese, si edhe Inspektoratit Qendror.

Sipas të dhënave<sup>33</sup> të vendosura në dispozicion nga Inspektorati Qendror të nxjerra nga sistemi “e – Inspektimi” për periudhën 2022 – 6 mujori i parë 2024<sup>34</sup> rezultojnë rastet si më poshtë:

Tabela 13 Rastet e inspektimit në fushën e mjedisit dhe ujëra nga AKB dhe IKMT

Numër subjektsh të inspektuara në fushën e mjedisit dhe ujërave nga AKB dhe IKMT	2022	2023	6 Mujori 2024
		149 subjekte	132 subjekte

Burimi: IQ

Përpunoi: GA

Ky fenomen nisur në vitin 2019, me ndryshimet e VKM - së nr. 502, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme", që i ka është shtuar këtij institucioni në fushën e përgjegjësisë së vet edhe “*parandalimin, mbrojtjen, mbikëqyrjen dhe kontrollin e zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apo ndërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji.*”<sup>35</sup> Këto përgjegjësi të reja janë ushtruar nëpërmjet IKMT - së në cilësinë e institucionit të varësisë përgjegjës për funksionet e inspektimit. Me VKM nr. 604 datë 20.10.2021, “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë Shtetërore të Ministrisë së Brendshme”, i cili ka shfuqizuar VKM – në e sipër cituar “*parandalimi, mbrojtja, mbikëqyrja dhe kontrolli/inspektimi i zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e tokës/territorit, ajrit, ujërave dhe pyjeve nga ndotje, dëmtime apondërhyrje të kundërligjshme të çfarëdo lloji*” ka vijuar të mbetet në fushën e përgjegjësisë së Ministrisë së Brendshme. Pikërisht këto fusha janë edhe pjesë e mbikëqyrjes dhe inspektimit të ushtruar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit në cilësinë e institucionit përgjegjës për inspektimin e kërkesave ligjore në fushën e mjedisit dhe ujërave.

<sup>33</sup> Të dhënat e plota për periudhën 2021 – 6 mujori i parë i vitit 2024 gjenden në Aneksin 1 të raportit të auditimit.

<sup>34</sup> Referuar përgjigjeve zyrtare të Inspektoratit Qendror, për vitin 2021 nuk janë konstatuar mbivendosje nga IQ në sistemin “e – Inspektimi”.

<sup>35</sup> Pika 3. Germa f, VKM nr. 502, datë 13.09.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Brendshme", i ndryshuar.

**3. Gjetje nga auditimi:** Inspektoratet në nivel vendor ushtrojnë aktivitetin e inspektimit pa mbikëqyrje nga Inspektorati Qendror. Sipas ligjit për vetëqeverisjen vendore, funksionet e inspektimit në nivel vendor krijohen apo përcaktohen me vendim të këshillit bashkiak të njësisë vendore përkatëse. Në këtë drejtim është evidentuar se, sa i takon mbikëqyrjes së zbatimit të ligjit për inspektimet dhe legjislacioneve specifike sektoriale, aktualisht Inspektorati Qendror nuk e ka tagrin ligjor për të kryer këtë proces pranë inspektorateve vendore. Me hyrjen në fuqi të ligjit të ri për inspektimet, kompetencat e Inspektoratit Qendror, i cili do të riorganizohet nën emërtimin Inspektorati i Përgjithshëm, janë zgjeruar dhe qartësuar në këtë drejtim, duke lejuar mbikëqyrje dhe bashkërendim të plotë.

**Konkluzion 1:** Mangësitë në dokumentacion, mospërputhja e të dhënave, shkeljet e procedurave ligjore gjatë kryerjes së inspektimeve nuk kanë ndihmuar në konsolidimin e procesit të inspektimit si një proces administrativ, duke e zhveshur atë nga rëndësia që i takon në drejtim të krijimit të një procesi inspektues në përputhje me parimet e ligjit për inspektimin dhe në mbrojtje të interesave të qytetarëve.

**Konkluzione 2:** Mbivendosja e veprimtarisë inspektuese ka krijuar barrë administrative për bizneset, por edhe mos - koordinim të vet institucioneve me funksione inspektuese, të cilat kanë dublikuar aktivitetin inspektues.

**Konkluzione 3:** Mungesa e mbikëqyrjes së funksioneve inspektuese në nivel vendor nuk ka lejuar që këto të mund të rrisin kapacitetet e tyre inspektuese në drejtim të të gjitha aspekteve që parashikon ligji për inspektimin dhe legjislacionet specifike të fushave konkrete inspektuese, duke mos favorizuar kështu koordinimin edhe me inspektoratet shtetërore.

**1.1 Rekomandim:** Inspektorati Qendror, i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm të përmbledhë në një raport specifik të gjitha problematikat lidhur me zbatimin e procesit të inspektimit në përputhje me bazën ligjore ende në fuqi (ligji nr. 10433/2011), me qëllim korrigjimin e këtyre fenomeneve me rikonceptimin ligjor, nënligjor dhe rregullator të procesit të inspektimit që do të zhvillohet në zbatim të ligjit nr. 99/2024.

*Brenda datës 30.04.2025*

**2.1 Rekomandim:** Inspektorati Qendror, i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm, në kuadër të riorganizimit të inspektorateve shtetërore në rang vendi sipas ligjit nr. 99/2024, në procesin e dhënies së mendimeve për aktet nën ligjore lidhur me këtë riorganizim, të orientojë me saktësi procesin vendimmarrës duke ndihmuar në ndarjen e duhur të kompetencave të inspektorateve shtetërore sipas fushave specifike inspektuese, duke patur një vëmendje të veçantë sa i takon eliminimit të mbivendosjeve midis IKMT-së dhe AKM-së.

*Në vijimësi*

**3.1 Rekomandim:** Inspektorati Qendror, i cili do të riemërtohet Inspektorat i Përgjithshëm, në kuadër të kompetencave të reja që i ka dhënë ligji nr. 99/2024, të marrë masa për të siguruar koordinim midis funksioneve inspektuese, të sigurojë mbikëqyrje të vazhdueshme për ligjshmërinë e veprimtarive inspektuese të inspektorateve vendore, duke patur si objektiv edhe shmangien e mbivendosjes së kompetencave me inspektoratet qendrore, duke siguruar orientim të qartë e të saktë në këtë drejtim.

*Në vijimësi*

## **6. KOMENTET E SUBJEKTIT**

Inspektorati Qendror ka dërguar komentet e tij mbi projektraportin e auditimit me shkresën nr. 464/2, prot., datë 20.12.2024, protokolluar me tonën me nr. 768/4, prot., datë 24.12.2024 në të cilën parashtron sa më poshtë:



**Lidhur me Gjetjen nga auditimi nr. 1 dhe konkluzionin nr. 1 (si më poshtë):**

“Ligji nr. 99, datë 12.09.2024 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, sa i përket vlerësimit të shkallës së përafrimit me legjislacionin e BE – se, është hartuar pa synuar përafrimin e tij me *acquis communautaire*. Gjithashtu, ai nuk është dërguar për komente pranë Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, sikurse parashikohet në Manualin për hartimin e ligjeve ku thuhet se projektligjet duhen dërguar edhe në Ministrinë e Integritit, e cila ka detyrimin që të vlerësojë përputhshmërinë e tyre me *acquis*-në e BE-së.<sup>36</sup> Po kështu, referuar manualit të hartimit të ligjeve, udhëzimit të Ministrit të Drejtësisë<sup>37</sup> dhe rregullores së Këshillit të Ministrave, hartuesit e ligjit duhet të sigurojnë që projektligjet dhe projektaktet nënligjore të respektojnë hierarkinë ligjore, si dhe duke marrë parasysh përafrimin me *acquis*-në e BE-së.<sup>38</sup>

**Konkluzion 1:** Fakti që nuk është bërë një vlerësim paraprak mbi përafrimin me legjislacionin e BE – së, mund të cenojë procesin e reformimit në fushën e inspektimeve, në veçanti sa i takon hartimit të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Lidhur me sa më sipër, Inspektorati Qendror shpjegon se ligji i ri është hartuar duke u bazuar në parimet e OECD – së, si dhe praktikave të mira të vendeve të tjera të BE – së. Po kështu shpjegon se është marrë edhe ekspertizë ndërkombëtare në fushën e inspektimeve me qëllim përshtatjen e metodave më të reja e të provuara sa i takon fushës së inspektimeve.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa i përket komenteve të subjektit nën auditim lidhur me gjetjen e sipërcituar, grupi i auditimit ka shpjeguar se është detyrim i procesit në të cilin kalon hartimi dhe miratimi i ligjeve që këto të përmbajnë elementin e vlerësimit të përputhshmërisë me legjislacionin e BE – së, për shkak të epërsisë absolute që ky legjislacion ka mbi legjislacionet e shteteve anëtare.

Në këtë kuadër është e rëndësishme që në fazat në vijim, të cilat do të kërkojnë hartimin dhe miratimin e akteve nënligjore në fushën e inspektimeve për inspektoriatet, ti kushtohet një rëndësi e veçantë shkallës së përafrimit me legjislacionin e BE – së për to, sikundër kërkohet edhe në rekomandimin përkatës.

**Lidhur me Gjetjen nga auditimi nr. 2 dhe konkluzionin nr. 2 (si më poshtë):**

“Gjatë auditimit është konstatuar se, Inspektorati Qendror ka hartuar dhe miratuar metodologjitë dhe rregullat për ushtrimin e funksioneve inspektuese, por nuk ka përditësuar Manualin e Përgjithshëm të Inspektimit që nga miratimi i tij në vitin 2015. Sipas parashikimeve të vet manualit, Inspektorati Qendror bashkëpunon me inspektoratet shtetërore dhe vendore dhe bën rishikimin dhe përditësimin e këtij manuali. Ky hap është i rëndësishëm pasi siguron që metodologjia dhe procedurat e inspektimit të mbeten në pajtueshmëri me praktikën më të mira dhe të pasqyrojnë ndryshimet në kuadrin ligjor dhe atë të inspektimit.

**Konkluzion 2:** Mos rishikimi i Manualit të Përgjithshëm të Inspektimit sipas një qasjeje gjithëpërfshirëse mund të cenojë përputhshmërinë me praktikën më të mira ndërkombëtare në fushën e inspektimit.”

Lidhur me sa më sipër, Inspektorati Qendror shpjegon se procesi i rishikimit të të gjithë komponentëve të manualit të përgjithshëm të inspektimit do të vijojë me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 99/2024, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 192, datë 13.11.2024.

<sup>36</sup> Manuali i hartimit të ligjeve, 2010.

<sup>37</sup> Udhëzimi nr. 6 ,datë 29.04.2022, Neni 48 “ Tabela e Përputhshmërisë”

<sup>38</sup> VKM nr. 584, datë 28.08.2003 “Për miratimin e Rregullores së Këshillit të Ministrave”, kreu III, pika 2.5.

**Qëndrimi i grupit të auditimit:** Nga ana e institucionit të KLSH – së do të auditohet të vijimësi, në përputhje me bazën ligjore dhe nënligjore në fuqi, zbatimi i rekomandimit të mësipërm, si dhe i rekomandimeve të tjera të lëna me këtë auditim.

## **KONTROLLI I LARTË I SHËTËTIT**